

Dr. Uvejid ibn Hamud el Ataviu

O djali im

Këshillat e Lukmanit drejtuar të birit

Përktheu: Almedin Ejupi

Redaktor fetar: Sedat Islami

Redaktor gjuhësor: Jeton Koqinaj

يا بني

مواعظ لقمان لابنه

(باللغة الألبانية)



تأليف: د. عويض بن حمود العطوي

ترجمة: ألمدين أيوبي

مراجعة شرعية: د. سدات إسلامي

مراجعة لغوية: يتون كوجيناي

HYRJE

Falënderimi i takon vetëm Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të Dërguarin e Tij.

Këto janë ca pushime në ajetet e sures “Lukman”, që kanë të bëjnë me këshillat e Lukmanit drejtuar djalit të tij. Për çdo mysliman është e njohur madhështia e Kuranit, këtij libri që përfshin mrekulli e paralajmërime, dije e mësim, udhëzime e margaritarë, te të cilët duhet të ndalemi për të përfituar prej tyre. Një ndër ta është edhe kjo këshillë madhështore, që konsiderohet pishtar, dritëlëshues e udhërrëfyes, në fushën e edukimit dhe udhëzimit, së cilës duhet t'i kushtojmë rëndësi të madhe.

Allahu i Lartësuar thotë: **“Ne i dhuruam Lukmanit urtësinë (duke i thënë): “Falënderoje Allahun! Kush është falënderues, e bën për të mirën e vet dhe, kush mohon, ta dijë se vërtet Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Denjë për lavdërim.” (Kujtoje) kur Lukmani i tha të birit, duke e këshilluar: “O djali im, mos i shoqëro Allahut asgjë (në adhurim)! Pa dyshim, idhujtaria është një padrejtësi shumë e madhe.” Ne e kemi urdhëruar njeriun që t’i nderojë prindërit e vet. Nëna e ka mbartur atë, duke duruar mundim pas mundimi, e ndarja e tij (nga gjiri) është brenda dy vjetësh. Ne i thamë atij: “Bëhu falënderues ndaj Meje**

dhe prindërve të tu! Tek Unë do të ktheheni të gjithë.” Nëse ata dy orvaten që të më shoqërosh Mua (në adhurim) diçka, për të cilën ti nuk ke dijeni, mos i dëgjo, por sillu mirë me ata në këtë jetë dhe ndiq rrugën e atij që drejtohet tek Unë me devotshmëri; pastaj, tek Unë do të ktheheni dhe Unë do t’ju lajmëroj për atë që keni bërë. “O djali im, edhe veprën e rëndë sa kokrra e sinapit që ndodhet në shkëmb, në qiej apo në tokë, Allahu do ta nxjerrë në shesh. Me të vërtetë, Allahu njeh mirë çdo imtësi dhe i di të gjitha fshehtësitë. O djali im, kryeje namazin, urdhëroje të mirën, pengoje të keqen dhe bëhu i durueshëm për çfarëdo që të godet! Me të vërtetë, ky është thelbi i patundur i të gjitha punëve! Mos i trajto njerëzit me nënçmim dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se Allahu nuk i do mendjemëdhenjtë e mburracakët! Ec me kujdes e i përmbajtur dhe fol me zë të ulët; se zëri më i vrazhdë është zëri i gomarit!” (Lukman, 12-19)

Në këtë punim do të bëjmë analizën e këtyre ajeteve duke i vështruar nga aspekti edukativ.

Lusim Allahun që ky libër t’i sjellë dobi lexuesit! Allahu është Garantuesi i suksesit!

Dr. Uvejd ibn Hamud el Ataviu

PARATHËNIE

Sikur të meditonim mbi këtë porosi përmbledhëse e gjithëpërfshirëse, do të shihnim se ajo nis me lavdërim ndaj këshilluesit për disa cilësi të tij të cilat e bëjnë të jetë kompetent për të lënë porosi. Këto cilësi janë gërshetuar në një cilësi të vetme, që është *urtësia*, sikur që thotë Allahu i Lartësuar: **“Ne i dhuruam Lukmanit urtësinë.”** Allahu thotë **i dhuruam** e jo **i dhamë**, ngase urtësia është çështje kuptimore, gjë e cila nuk është pronë e veçantë për dikë, por atë i jep Allahu vetëm kujt të dojë. Domethënë, urtësia përfshin çdo mirësi, ashtu siç thotë Allahu i Lartësuar: **“Cilitdo që i është dhënë urtësia, vërtet që i është dhënë një mirësi e madhe.”** (El Bekare, 269) Për këtë qëllim, Allahu urtësinë e ka bërë cilësi të të dërguarve dhe lajmëtarëve të Tij. Allahu ka urdhëruar të falënderohet për këtë mirësi dhe dhunti, duke thënë: **“Falënderoje Allahun!”** Vallë, a po orvatemi ne për ta fituar këtë urtësi? A i kemi kërkuar Zotit tonë që të na e dhurojë atë e të na japë sukses në të? Nëse tashmë na është dhënë, a e kemi falënderuar Zotin për këtë urtësi? Kjo urtësi është portretizuar në forma praktike në porosinë e Lukmanit drejtuar të birit të tij, ngase edukimi konsiderohet ndër detyrat më të vështira dhe,

njëkohësisht, ndër më të rëndësishmet. Edukimi ka nevojë për urtësi, që nënkupton vënien e diçkaje në vendin e duhur.

Prandaj, le ta studiojmë në thellësi këtë porosi madhështore që e ka përjetësuar Allahu në Librin e Tij, në mënyrë që për ne dhe mbarë botën të jetë dritë udhëzimi dhe shenjë adresimi në këtë fushë të gjerë e madhore, siç është edukimi.

“Kujtoje) kur Lukmani i tha të birit, duke e këshilluar...”

Le të meditojmë fjalën e përmendur në fillim të këtij udhëzimi të këtij udhëzimi. Kjo argumenton se sa e domosdoshme është të ketë diskutime dhe takime me fëmijët, si dhe këshilla t’u drejtohet me butësi. Po të shikonim realitetin tonë, me gjasë, do të hasnim prindër që nuk i kushtojnë rëndësi kësaj tematike. Në programin e tyre nuk ekziston *kohë për bisedë me djemtë dhe vajzat e tij*, por ajo bëhet në rastësi dhe ngjarje fatkeqësish, situata këto në të cilat nis këshillimi dhe udhëzimi!

Ajo që bie në sy është se Allahu i Lartësuar thotë **“...të birit, duke e këshilluar...”** Pra, ajo është këshillë, gjë e cila nënkupton butësi. Këshilla nënkupton atë që e zbut zemrën dhe ndikon në shpirt, butësinë, dhembshurinë dhe rikujtimin me atë që nxit emocionet dhe ndikon në ndjenja, e assesi ofendimin e sharjen.

Sot, ndonjëri prej nesh, veçanërisht në rrethin e intelektualëve, këshillën e sheh si diç të parëndësishme apo të papërshtatshme. Prandaj, kur ky dëshiron të

gjykojë ndonjë fjalim si të thjeshtë e sipërfaqësor, thotë: “Ky është fjalim këshillues, predikues.” Ç’është e vërteta, çdo zemër ka nevojë për predikim dhe rikujtim me atë që e zbut dhe e edukon, në mënyrë që të arrihet ekuilibri në jetë. Ne kemi nevojë t’i adresohemi shpirtit ashtu siç i drejtohem mendjes. Këshillë e vërtetë është ajo që përfshin tërë këtë, ashtu siç e hasim në këshillimin e Lukmanit drejtuar të birit të tij.

Mirësi dhe butësi është edhe metoda me të cilën Lukmani e thirri të birin e tij, duke iu drejtuar me fjalët: **“O djali im.”** Sa fjalë e butë dhe e bukur që është! I përmbledh të gjitha format e lidhjes ndërmjet të atit dhe të birit. Është fjalë që u drejtohet emocioneve të djalit, ngase kap dhe prek lidhjet më madhështore ndërmjet atësisë dhe bijësisë.

Ajo që ia shton edhe më tepër bukurinë dhe ndikimin kësaj shprehjeje është forma përkëdhelëse e saj, që në vete ngërthen bukurinë dhe butësinë. Ky modalitet është i rëndësishëm gjatë komunikimit me fëmijët. Nuk është e domosdoshme që thirrja të jetë me ndonjë emër që nuk përmban ngrohtësi, por më e mira është që djali të thirret me atë që ia kujton këtë lidhje. Gjithashtu, edhe babai të thirret kësisoj. Ibrahim i thirri djalin e tij duke i thënë: **“O djali im...”** (Safat, 102) Gjithashtu, Nuhu veproi kësisoj: **“O djali im...”** (Hud, 42) Ibrahim i kishte thirrur të atin me fjalët: **“O babai im...”** (Merjem, 42), kurse babai i tij Ibrahimin e kishte thirrur me zemërim dhe

ashpërsi, duke i thënë: **“Ai iu përgjigj: “O Ibrahim! Si guxon t’i hedhësh poshtë zotat e mi?! Nëse nuk heq dorë, unë do të të mbys me gurë; andaj, largohu prej meje për një kohë të gjatë!”** (Merjem, 46), e nuk i tha: **“O djali im.”**

Butësia është gjuha e profetëve. Butësia gjatë komunikimit është tipar i të devotshmëve. Po ne, si sillemi me djemtë dhe vajzat tona? A mos kemi nevojë për një rishikim të mënyrës së diskutimit dhe bisedimit me ta?

POROSIA E PARË

MOSSHOQËRIMI ALLAHUT ASGJË (NË ADHURIM)

“O djali im, mos i shoqëro Allahut asgjë (në adhurim)! Pa dyshim, idhujtaria është një padrejtësi shumë e madhe.”

Kjo është porosia e parë në këtë këshillim. Vini re si ka filluar: **“O djali im, mos i shoqëro Allahut asgjë (në adhurim)! Pa dyshim, idhujtaria është një padrejtësi shumë e madhe.”**

la tërhoqi vërejtjen për bazamentin dhe gjënë kryesore. E porositi për njëzim (monoteizmin), për atë çfarë duhet të besojë. Kjo është një çështje që, për shkak të pakujdesisë, disa prindërve nuk u shkon ndërmend, ndërkohë disa të tjerë arsyetohen duke thënë se ne tashmë jemi njësuës, myslimanë, prandaj, përse ta bëjmë këtë?

Përkundër faktit se Lukmani dhe i biri i tij ishin besimtarë, Lukmani nuk e neglizhoi këtë themel madhështor, në të cilin të gjithë të dërguarit i kanë thirrur popujt e tyre, para se t’i thërrisnin e t’ua shpjegonin hollësitë e adhurimeve.

O prind, assesi mos thuaj se i mjafton mësimi (i edukatës fetare) në shkollë. Ti ke përgjegjësi të veçantë për këtë çështje. Ti, kohë pas kohe, duhet të ulesh me fëmijët e tu, t’u flasësh rreth kësaj tematike, t’ua sqarosh rrezikun e politeizmit (shirkut) dhe format e tij. Në asnjë mënyrë

mos thuaj se këto janë gjëra të ditura. Përkundrazi, realiteti i tyre mund të jetë i panjohur te shumica e fëmijëve. Tërhiqja vërejtjen rreth rrezikut të magjisë, gënjeshtarëve, mashtrimit dhe besëtytnive, në mënyrë që të mos bien në grackën e tyre me avancimin e mjeteve teknologjike. Prandaj, nëse nuk ekziston përmbajtja subjektive në brendinë e tyre, atëherë nuk do të mund t'i njohin e t'i kenë nën kontroll këto gjëra.

Shpjegojua madhështinë dhe fuqinë e Krijuesit, që krijimi dhe urdhri i takojnë vetëm Atij, se vetëm Atë duhet ta adhurojmë dhe se Ai na sheh gjithmonë, kudo që jemi. Të gjitha këto i përfshin kjo porosi madhështore. E gjithë kjo në zemrat e tyre ndërton mbikëqyrje të veçantë që kontribuon në edukimin e sjelljes dhe korrigjimin e moralit të tyre. Lutu për ta që Allahu t'i ruajë nga e keqja, ngase askush nuk është i mbrojtur. Shiko se si është lutur Ibrahim, *alejhi selam*: **“Më ruaj mua dhe pasardhësit e mi nga adhurimi i idhujve!”** (Ibrahim, 35) Ai frikësohej për veten dhe fëmijët e tij nga kjo rrëshqitje, ndërkohë ishte profet. Po ne?! Vallë, ne dhe fëmijët tanë kemi siguri nga shirku? Kurrsesi. Prandaj, ne duhet të frikësohemi nga rrëshqitjet në shirk dhe ateizëm, t'ua tërheqim vërejtjen të kenë kujdes prej tyre dhe t'i paralajmërojmë fëmijët tanë nga gjithë kjo.

Lukmani e ndaloi të birin nga shirku, idhujtaria, sepse është rreziku më i madh për adhurimin e njeriut, është padrejtësi kundrejt të drejtës së Krijuesit të Lartësuar, si

dhe kundrejt të drejtës së krijesave, ndaj i ka treguar arsyen duke thënë: **“Pa dyshim, idhujtaria është një padrejtësi shumë e madhe.”**

Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ua tërhoqi vërejtjen shokëve të tij të ndershëm nga rreziku i kësaj padrejtësie, kur u shpall ajeti kuranor: **“Sa për ata që besojnë dhe nuk e molepsin besimin e tyre me padrejtësi (idhujtari)...”** (El Enam, 82) atyre u kishte ardhur vështirë, ndaj kishin thënë: “O i Dërguari i Allahut! E cili prej nesh nuk i bën padrejtësi shpirtit (vetvetes)?” Atëherë Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, u ka thënë: “Qëllimi i ajetit (në fjalë) është shirku e jo çfarë po mendoni ju. A nuk e keni dëgjuar thënien e Lukmanit drejtuar të birit të tij: **“O djali im, mos i shoqëro Allahut asgjë (në adhurim)! Pa dyshim, idhujtaria është një padrejtësi shumë e madhe.”** (Mutefekun alejhi)

Ky shpjegim konsiderohet parim madhështor edukativ, ndaj të cilit janë të pavëmendshëm shumë edukatorë. Çështja nuk është thjesht urdhër apo ndalesë, por shpjegim, qartësim dhe sqarim. Kjo është esenca e edukatës së shëndoshë. Fëmija arrin të kuptojë përse është ndaluar nga diçka apo përse është urdhëruar, prandaj nuk këmbëngul e as diskuton.

Prind i nderuar! Duhet të kujdesesh për këtë çështje. Mos e shpërfill mendimin e asnjërit prej fëmijëve të tu. Kur të urdhërosh apo kur të ndalosh, arsyetojua atë. Kjo duhet

bërë në një kohë të përshtatshme qetësie, butësie dhe rehatie.

Në shpjegimin dhe arsyetimin tënd le të ketë besueshmëri të mjaftueshme. Nëse fëmija vazhdon së pyeturi, atëherë përgjigju dhe diskuto me të. Kësisoj do ta përfitosh, do të kesh ndikim tek ai dhe do të bëhet kënaqësi e syrit tënd.

Ja, shfletuam ca faqe, kaluam disa çaste me një pjesë të kësaj porosie madhështore dhe pamë se kjo porosi përfshin bazat e duhura të udhëzimit. E, disa nga bazat më të rëndësishme janë:

Së pari: Arritja e shkathtësive të duhura për udhëzim. Ndër to është edhe urtësia, që fitohet vetëm me dije e përvojë, prandaj, o prind, çfarë ke bërë për të arritur këtë? A ke lexuar e a ke nxënë dije? A ke pyetur dhe mësuar? A ke ushtruar dhe stërvitur? E tërë çështja të takon ty, puno për hir të fëmijëve të tu, ata janë kapitali yt.

Së dyti: Butësia, dashamirësia dhe këshillimi i tyre veças. Kjo manifestohet gjatë këshillimit, prandaj, ki parasysht këtë fakt. Largoju dhunës, ashpërsisë, ofendimit, kritikës së ashpër dhe mos e shndërro këshillën në skandal dhe turpërim.

Së treti: Ndërtimi i urave të bashkëpunimit përmes mbajtjes së afërsisë, përzgjedhjes së shprehjes së përshtatshme që bën të ndiejë afërsi dhe dashuri *'o djali*

im. E, nëse has vështirësi në këtë, atëherë ushtrohu në këtë aspekt dhe kërko mjete që të ndihmojnë në këtë drejtim, bie fjala, të luash me fëmijët e tu, t'i shoqërosh në gëzimet e tyre, në mënyrë që të afrohen zemrat dhe shpirtrat, e atëherë ato do të jenë të gatshme për të pranuar këshillën. O prind, provo të ulesh afër fëmijës tënd, vërja dorën mbi kokë dhe supe e shprehi fjalët: o djali im. Ji i bindur se kjo fjalë, ky veprim e ky ledhatim lë gjurmë shumë herë më shumë se fjala që ia thua në ndonjë situatë tjetër. Ky veprim largon çdo pengesë mes teje dhe tij, ia hap zemrën fëmijës për të pranuar, ngase atëherë ndien turp të të kundërshtojë dhe vetja e tij anon nga dëgjimi dhe pajtimi me ty.

Së katërti: Përzgjedhja e temës së përshtatshme, ofrimi i prioriteteve, gjë e cila mund të ndryshojë, varësisht situatës, fëmijës dhe tematikës. Orvatu t'i vlerësosh gjërat duke filluar me aspektet e përgjithshme dhe ato që janë të rëndësishme.

Së pesti: Këshilla jote ndaj fëmijës le të jetë e gjithanshme, të përfshijë të gjitha porët e jetës së kësaj bote dhe botës tjetër. Këshilla le të përfshijë besimin e tij, adhurimin dhe moralin, ashtu siç është përmendur në porosinë e Lukmanit drejtuar të birit të tij.

Së gjashti: Ashtu siç iu qasesh emocioneve të fëmijës, drejtoju mendjes së tij. Lukmani i është drejtuar emocioneve të të birit duke shqiptuar fjalët: **“O djali im”**, kurse mendjes i është drejtuar kur i është arsyetuar me

fjalët: **“Pa dyshim, idhujtaria është një padrejtësi shumë e madhe.”** Doemos duhet t’i japësh hapësirë të mjaftueshme për të menduar dhe për t’u bindur me atë çfarë i thua. Qëllimi nuk është ndikimi i i menjëhershëm, por mbjellja e vlerave dhe parimeve.

Kësisoj, mbajmë lidhjet me fëmijët dhe i zhvillojmë shkathtësitë tona për hir të të tyreve. Kjo nuk është pak për të drejtën e tyre. Sa bukur është t’i mbjellim frytet e arrira në mënyrë që të na kthehen të dobishme kur të piqen! Ç’gëzim madhështor kaplon fytyrat dhe zemrat kur prindërit iu rikthehen fëmijëve!

POROSIA E DYTË

RESPEKTIMI I PRINDËRVE

“Ne e kemi urdhëruar njeriun që t’i nderojë prindërit e vet. Nëna e ka mbartur atë, duke duruar mundim pas mundimi, e ndarja e tij (nga gjiri) është brenda dy vjetësh. Ne i thamë atij: “Bëhu falënderues ndaj Meje dhe prindërve të tu! Tek Unë do të ktheheni të gjithë.”

Le të ndalemi te lidhshmëria e përmendjes së kësaj porosie nga Allahu në kuadër të këshillës së Lukmanit drejtuar të birit, si dhe përfshirjen e saj në të. Lidhshmëria qëndron në nderimin e çështjes së prindërve dhe lidhjen e së drejtës së prindërve me të drejtën e Allahut të Lartësuar. Pra, sikur është thënë: O Lukman! Nëse ti dhe të gjithë ata që janë si ti kujdeseni për të drejtën e Allahut në njëzimin e Tij, atëherë dije se në këtë këshillë Allahu do të kujdeset për të drejtën tënde, o prind, si dhe duke i urdhëruar fëmijët për nderimin, respektin, kujdesin si dhe njohjen e së drejtës sate.

Ç’porosi e mahnitshme nga Zoti i Madhërishëm për të gjithë fëmijët! Porosi për fëmijët që të kujdesen për të dy prindërit, të cilëve u takon e drejta madhështore. Të drejtën e tyre, menjëherë pas të drejtës së Tij, Allahu i Lartësuar e ka radhitur në më shumë se një vend në Kuran. I Lartësuari thotë: **“Kujtoni kur Ne morëm besën tuaj, o bijtë e Israilit, se do të adhuronit vetëm Allahun,**

do të silleni mirë me prindërit.” (El Bekare, 83)
Gjithashtu thotë: **“Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim); silluni mirë me prindërit.”** (En Nisa, 36)

Po ashtu thotë: **“Thuaju: “Ejani t’ju lexoj çfarë ju ka urdhëruar Allahu: që të mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim); që të silleni mirë me prindërit...”** (El Enam, 151) Dhe në një vend tjetër thotë: **“Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuroni askënd tjetër përveç Atij dhe, që të silleni mirë me prindërit.”** (El Isra, 23)

Në këto ajete të njëpasnjëshme a vure re lidhshmërinë e jashtëzakonshme ndërmjet të drejtës së Allahut në njëzim dhe të drejtës së prindërve në bamirësi e respekt? Më pas, shiko, Allahu të pastë në kujdesin e Tij, shprehjen ‘vesije’ (porosi), se ajo buron nga Allahu. Ajo me këtë shprehje është përsëritur katër herë në Kuran. Shiko rëndësinë e kujdesit ndaj atij që i drejtohet këshilla, pastaj kontrollo veten e vlerëso pozicionin tënd përballë prindërve të tu dhe, në fund, shiko seriozitetin e defektit në këtë problematikë thelbësore.

Përdorimi i shprehjes “insan” (njeri) te fjala e Allahut të Lartësuar: **“Ne e kemi urdhëruar njeriun”** dhe jo shprehja “besimtarin” apo “myslimanin”, është argument se mbetet e drejta e prindërve, pavarësisht feve. Këtë që thamë e përforcon fakti se shprehja “njeriu” (në arabisht) ka ardhur me një shqese *e*, që nënkupton çdo njeri, pa marrë parasysh llojin, fenë, prejardhjen apo gjuhën e tij. Sa e drejtë madhështore që është kjo!

Esma bint Ebu Bekër, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, thotë: “Njëherë, më vizitoi nëna, e cila akoma nuk ishte besimtare, në kohën e të Dërguarit të Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, kështu që e pyeta atë: “O i Dërguari i Allahut! A t’i mbaj lidhjet me nënën time?” Ai më tha: “*Po, mbaji lidhjet me nënën.*” (Shënojnë Buhariu dhe Muslimi)

Hatabi thotë: “Në hadith ka argument se lidhjet duhen mbajtur edhe me farefisn jobesimtar, përfshirë pasurinë e gjëra të tjera, ashtu siç mbahet lidhja me farefisn mysliman. Gjithashtu, nga hadithi mësojmë detyrimin e furnizimit të babait dhe nënës jobesimtarë, edhe nëse fëmija është mysliman.”

Përcaktimi i të porositurit ka ardhur qartë: **prindërit e vet**, në mënyrë që të përfshihen bashkë nëna dhe babai. Prandaj, porosia vlen për të dytë. Ndërkohë, kundrejt kësaj nuk gjejmë ndonjë porosi të tillë për prindërit ndaj fëmijëve, sepse Zoti i Madhërishëm i ka lidhur zemrat e prindërve me fëmijët, e kjo nuk ekziston te fëmijët, në të kundërtën medoemos do të kishte porosi. Është thënë: “Zemra më copëtohet për fëmijën, kurse fëmija tregohet zemërgur me mua.” Është transmetuar se kur Lukmani i kishte treguar këtë djalit të tij, i ishte drejtuar: “Me të vërtetë, Allahu më ka bërë të kënaqur me ty, ndaj nuk më ka porositur për ty, kurse ty të ka bërë të pakënaqur me mua, ndaj të ka porositur për mua.”

Pas këtij përgjithësimi të porosisë ndaj dy prindërve, pasojnë detajet. Është veçuar nëna për shkak të së drejtës madhështore të saj, vlerës së madhe, pafuqisë së gjendjes së saj, si dhe vështirësive të shumta që ka.

Allahu thotë: **“Nëna e ka mbartur atë, duke duruar mundim pas mundimi.”** Kjo është gjendja që sqaron vështirësitë e shumta dhe pafuqinë e madhe, me bujarinë e përsosur që buron nga kjo nënë madhështore. Në pjesën **e ka mbartur atë**, është për qëllim vështirësia kryesore, shtatzënia, që konsiderohet ndër veçoritë më të theksuara të grave. Allahu në këtë ajet ka nderuar nënën, për t’ia njohur vlerën, bujarinë dhe sakrificën e saj të madhe, për dallim nga ajo që propagandojnë thirrësit e të ashtuquajturit civilizim, që këtë krijim hyjnor, të veçantë për femrën, mundohen t’ia veshin e ta modifikojnë edhe për burrin, si dhe aspekte të tjera kundërshtuese të natyrës së shëndoshë.

Përmendja e nënës këtu në këtë thënie të Allahut të Lartësuar: **“Nëna e ka mbartur atë, duke duruar mundim pas mundimi”**, tregon se kjo vlerë është specifike vetëm për të, si dhe kur femra bëhet nënë vetëm pas një martese të ligjshme e të bekuar. Përmendja e shprehjes *nënë* shfaq simbolin që duan ta shuajnë thirrësit e rrejshëm të lirisë. Është simboli i mëmësisë. Sot, ne dëgjojmë vetëm për të drejtat, lirinë dhe punën e gruas, mirëpo fare pak dëgjojmë për nënën dhe bashkëshorten, në kuptimin e plotë të fjalës *nënë* dhe *bashkëshorte*.

Allahu e ka sqaruar veçantinë e kësaj mbartjeje (shtatzënie) dhe mënyrën e saj. Ai thotë **“mundim pas mundimi”**. Mundimi këtu paraqet dobësi, pafuqi për të bartur diçka. Mundimi ka ardhur me paskajore, për të treguar ekzagjerimin e dobësisë së saj, sikur vetë ajo është mundimi! Sa përshkrim madhështor dhe sa zbulim i mahnitshëm!

Nëna, vërtet dobësohet kur sakrifikon një pjesë të qenies për foshnjën e saj, sepse foshnja është pjesëmarrëse në fuqinë, ushqimin dhe lëvizjen e saj, derisa dobësohet për shkak të foshnjës. Por, për çudi, nëna është e gëzuar dhe e lumtur me këtë. Lartësuar qoftë Allahu, i Cili, në zemrën e nënës, ka krijuar dhembshuri për foshnjën dhe ka bërë të gëzohet me dhimbjet e saj. A mund të realizohet kjo përmes takimeve të ndaluara dhe lidhjeve të paligjshme ndërmjet burrit dhe gruas? Kurrsesi.

Le të meditojmë mbi të gjitha përmasat e këtij mundimi, ashtu siç e portretizon fjala e të Lartësuarit **mundim pas mundimi**. S'është thjesht një mundim, por mundime të shumta, që shtohen me kalimin e ditëve të shtatzënisë.

Sa e mirë është kjo nënë bujare sakrifikuese! Sa neglizhues jemi treguar në të drejtën dhe meritën e saj! Kjo gjendje, **mundim pas mundimi**, ka ardhur si shpjegim i kësaj porosie madhështore, ngase çdo nënë e përjeton këtë. Porosia është sqarim për një çështje gjithëpërfshirëse, e jo për diçka specifike, që mund të jetë vetëm te një nënë, e jo te tjetra. A ke vënë re këtë, o besimtar? Po qe se njeriu do të përsiaste mbi këtë çështje, do të vërente se ky fakt është shtytës në shpirtin e fëmijës, që ta nderojë nënën e tij sepse kjo është bujari, mirësi, sakrificë, që as mund të mohohet, as mund të shmanget.

Krahas shtatzënisë, kemi bujarinë tjetër, që vjen pas saj: gjidhëniën, ku mes tyre është lindja dhe dhimbjet e saj, gjë që sqarohet te fjala e të Lartësuarit: **"... ndarja e tij (nga gjiri) është brenda dy vjetësh."** Këtu më tepër hasim kujdesin e sqarimit të periudhës (dyvjeçare) sesa

sqarimin e formës dhe gjendjes, siç është te shtatzënia. Gjithënia, nga aspekti kohor, është shumë më e gjatë sesa shtatzënia dhe, tërë kjo periudhë e gjatë, është sakrificë e flijim nga nëna fisnike. Paraprakisht, të ka ushqyer në brendinë e saj, e më pas të ka ushqyer me gji. Kjo, për plot tridhjetë muaj, duke të të dhuruar nga gjaku i saj, ushqimi dhe qenia. Allahu i Lartësuar thotë: **“Njeriun e kemi porositur të jetë i sjellshëm ndaj prindërve të vet. Nëna e mbart atë me mund dhe me mund e lind. Ai mbartet dhe ushqehet me gji për tridhjetë muaj.”** (El Ahkaf, 15)

Ja, e tillë është nëna, simboli më i madh i sakrificës dhe flijimit, faljes dhe zemërbutësisë, dashurisë dhe mirësisë. Po ne, ku jemi në raport me këtë? A e kemi kuptuar meritën e saj?

Në bregdet disa të rinj e kishin parë një grua të moshuar që në duar mbante një copë letër. Kur në mbrëmje e pyetën për këtë, ajo iu përgjigj: “Këtu më solli djali im që nga mëngjesi e më tha se do të kthehej dhe ma dha këtë letër.” Ajo as kishte ngrënë, as kishte pirë tërë ditën. Të rinjtë e panë letrën që kjo grua e mbante në dorë, ku shkruante: “Kush e gjen këtë të moshuar, le ta dërgojë në azil pleqsh.” Nëna mendonte se aty kishte të shkruar numrin e celularit të djalit të saj, që do të kthehej tek ajo, prandaj dhe këmbënguli të mbesë dhe të presë kthimin e tij. U bë merak e u mërzi për djalin e saj, iu përkeqësua gjendja, iu ngrit shtypja dhe u nda nga jeta duke pritur të takohej me të birin, ndërkohë, ai pret ndarjen e saj. Ç’dallim i madh ndërmjet dy zemrash!

Të kërkojmë ndjesë, oj nënë! Ti neve na ofrove dashurinë dhe besnikërinë, kurse ne ta kthjem me ashpërsi e vrazhdësi. Na e shtrove tokën me sakrificë dhe flijim, kurse ne jetën ta bëmë të zyrtë e me fatkeqësi. Ne të lëndojmë ty, kurse ti na e kthen me të mirë. Të takojmë fytyrëvrazhdë, kurse ti na e kthen me buzëqeshje, tregohemi koprracë ndaj teje, kurse ti na bën mirë. Zemra jote për ne është e mëshirshme, kurse zemrat tona kundrejt teje janë të ashpra.

Nënë! Nëse ne e kemi nëpërkëmbur të drejtën tënde, Allahu e ka ruajtur atë të drejtë për ty, e ka lartësuar meritën tënde dhe se bujaria e fisnikëria jote do ta fshijë ashpërsinë dhe vrazhdësinë tonë, ngase ti je nënë, dhe kjo mjafton.

Pas këtij udhëzimi hyjnor e madhështor, ajeti fisnik përfundon me urdhrin për falënderim ndaj Allahut të Lartësuar e pastaj edhe ndaj prindërve. Allahu i Lartësuar thotë: **“Ne e kemi urdhëruar njeriun që t’i nderojë prindërit e vet. Nëna e ka mbartur atë, duke duruar mundim pas mundimi, e ndarja e tij (nga gjiri) është brenda dy vitesh. Ne i thamë atij: “Bëhu falënderues ndaj Meje dhe prindërve të tu! Tek Unë do të ktheheni të gjithë.”** Sa kuptim madhështor ka ky ajeti! Udhëzon drejt edukatës që duhet të kemi me personin që i takon merita, si dhe si duhet të sillemi me të. Është mësim për mohuesit kundërshtues. Porosit besnikëri ndaj personit që e ke obligim, në kohën kur po humbet besnikëria. Falënderimi, fillimisht, është për Allahun, i Cili e ka krijuar atë nënë për ty, pastaj ia lidhi zemrën e saj për ty e, më

pas, me këtë pamje të mrekullueshme e të mahnitshme, të ka krijuar në barkun e saj. Prandaj, falënderimi dhe mirënjohja të takon Ty, o Allah, fillim e mbarim, haptazi e fshehurazi.

Por, o njeri, mos harro falënderimin edhe ndaj prindërve të tu, të cilët u kujdesën për ty kur ishe i vogël e i rritur, mirëpo gjendja jote në vegjëli është argument më i madh për nevojën tënde për ata dy, dhe kujdesin e tyre të madh ndaj teje. Prandaj, Allahu e ka përmendur këtë në fjalën e Tij: **“O Zoti im, mëshiroji ata, ashtu siç më kanë rritur, kur unë isha i vogël!”** (El Isra, 24)

Këtu vihet re se si është përmendur falënderimi i të dy prindërve bashkërisht, nëna dhe babai, ndërsa është veçuar nëna në fillim të kësaj porosie dhe nuk është përmendur bashkë me të edhe babai, ngase vështirësitë dhe mundimet e nënës gjatë periudhës së shtatzënisë janë diçka që nuk e shoqëron askush atë, as babai, as kurrkush tjetër. E, kur të lindë foshnja, kujdesi nga ana e saj është edhe më i lartë. Tërë ajo që babai mund t’i ofrojë fëmijës pas kësaj periudhe, mund t’ia ofrojë edhe nëna e të jetë bashkëpjesëmarrëse, kurse babai nuk mund të jetë bashkëpjesëmarrës me nënën në proceset e shtatzënisë, lindjes e gjidhënies, prandaj dhe çështja e saj është lartësuar në respekt dhe pozitë. Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, iu përgjigj burrit i cili e pyeti: “Kush meriton më shumë mirësjelljen dhe përkujdesjen time?” *“Nëna jote.”* Burri e kishte pyetur: “Po pastaj?”

Pejgamberi i qe përgjigjur: *“Nëna jote.”* Burri e kishte pyetur sërish: *“Po pastaj?”* Pejgamberi i qe përgjigjur: *“Nëna jote.”* Ai përsëri e kishte pyetur: *“Po më pas?”* Pejgamberi i qe përgjigjur: *“Pastaj babai yt.”* (Shënon Buhariu) Ibn Haxheri thotë: Ibn Betali ka thënë: *“Nga kjo rezulton se nëna meriton trefish më shumë mirësjellje sesa babai... dhe kjo për shkak të vështirësisë së shtatzënisë, lindjes dhe gjdhënies. Këto janë aspektet me të cilat veçohet nëna, kurse më pas është bashkëpjesëmarrëse me babanë në edukim... Janë të barabartë në kujdestari, kurse nëna është e veçuar me tri çështje të tjera.”*

Mos të të mashtrojë jeta e kësaj bote dhe çfarë ka në të, ngase një ditë patjetër do të shohësh atë çfarë ke bërë. Bëj mirë, do të gjesh rezultatet, ngase shpeshherë e mira i sjell dobi njeriut. Ki kujdes mosrespektimin, edhe nëse mbytesh e digjesh, edhe nëse të jepet pozitë, margaritarë e xhevahire.

Poeti shkruan:

“Një ditë, një njeri kishte joshur një djalosh të paditur, të cilit ia donte të keqen, duke i thënë që t’ia sillte zemrën e nënës së tij, që në kundërvlerë t’i jepte monedha prej xhevahiri e margaritarë. Djaloshi kishte shkuar e ia kishte çarë gjoksin nënës dhe ia kishte prerë zemrën. Pastaj, mori ato që i kishte prerë dhe u nis me vrap drejt atij personi. Rrugës, meqë ngutej, u rrëzua përtokë. Kështu, zemra e nënës i kishte rënë në tokë dhe i rrokullisej, kurse

ky s' mund të ngrihej. Ngaqë ky u bë i tëri me baltë, zemra e nënës e thirri duke i thënë: "Biri im! Oj loçka ime, a mos u lëndove?" Befas, meqë zëri i zemrës së nënës së tij ishte shumë përdëllestar, u duk sikur zemërimi i qiejve kishte rënë mbi këtë djalosh, ndaj ky e nxori kamën (thikën) për ta vrarë veten, gjë që do të bëhej për të marrë mësim të gjithë ata që do të dëgjonin për këtë, porse zemra e nënës i bërtiti duke i thënë: "Ndale dorën dhe mos e mbyt zemrën time për herë të dytë!"

O Zot, sa e mëshirshme është zemra e nënës! Zemërdhembshuri ndaj nesh edhe përkundër ashpërsisë sonë. Zemra e saj na ndien, edhe nëse distancohemi nga ajo.

Sa zemër e madhe e plot dashuri! Sa të këqija u bëjmë prindërve tanë!

Është një thirrje për të medituuar në këtë porosi hyjnore e madhështore, në mënyrë që të përfitojmë prej saj e të njohim të drejtat e prindërve tanë. Fëmijë të nderuar, ndaluni në këtë porosi dhe sekretet e saj. Shikoni raportet me prindërit, me theks të veçantë me nënën. Kujtoni mirësitë, meritën, bamirësinë dhe bujarinë e saj, qëndrimin me net të tëra pa gjumë, dhe përpiquni t'ia ktheni disa bukuri të saj, të paktën duke mos e lënduar.

POROSIA E TRETË

NUK KA BINDJE (NDAJ TJETRIT) NË MËKATIM

“Nëse ata (dy) orvaten, që të më shoqërosh Mua (në adhurim) diçka, për të cilën ti nuk ke dijeni, mos i dëgjo, por sillu mirë me ata në këtë jetë dhe ndiq rrugën e atij që drejtohet tek Unë me devotshmëri; pastaj, tek Unë do të ktheheni dhe Unë do t’ju lajmëroj për atë që keni bërë.”

Allahu na ka porositur për t’i nderuar prindërit tanë, kurse nënën e ka veçuar për shkak të së drejtës së madhe të saj, meritën e plotë, bujarinë e pakursyer, dhurëtitë e saj të dukshme, e më pas ka urdhëruar falënderimin e Tij dhe falënderimin e dy prindërve, duke pranuar kësisoj mirësinë e tyre e duke ua kthyer vetëm një pjesë të dashamirësisë së tyre. Krahas të drejtës së tyre madhështore dhe porosinë ndaj tyre, duhet pasur parasysh se e drejta e Allahut është më e madhe dhe se feja e Tij është më e rëndësishme. Nëse vjen çështja të zgjidhet ndërmjet të drejtës së Allahut dhe të drejtës së prindërve, sa i përket respektimit, atëherë i jepet prioritet të drejtës së Allahut kundrejt të drejtës së prindërve. Mu për këtë Allahu i Lartësuar thotë: **“Nëse ata orvaten, që të më shoqërosh Mua (në adhurim) diçka, për të cilën ti nuk ke dijeni, mos i dëgjo.”** Ibn Kethiri thotë: “Nëse ata mundohen (të të bëjnë) t’i pasosh në fenë e tyre, ndërkohë janë idhujtarë, atëherë ki kujdes, ti dhe ata, mos i dëgjo në këtë çështje, se kthimi juaj do të jetë tek Unë në Ditën e Gjykimit. Unë do të të shpërblej për shkak të respektimit tënd ndaj tyre, për

shkak të durimit në fenë tënde, si dhe do të të ringjall bashkë me vepërmirët dhe jo me prindërit e tu, edhe nëse je personi më i afërt për ta në jetën e kësaj bote. Njeriu në Ditën e Gjykimit do të ringjallet me atë që do, respektivisht dashuri fetare.”

Prindërit mund të orvaten duke e larguar fëmijën e tyre nga e vërteta dhe ta detyrojnë drejt devijimit. Me këtë rast shfuqizohet bindja ndaj tyre dhe mbetet dëgjimi në mirësi në çështjet e kësaj bote. Edhe pse kjo rrallë mund të ndodhë, mirëpo nëse ndodh, ky është vendimi fetar. Për këtë qëllim, i Lartësuar ka thënë **“Nëse ata orvaten”** pra, ka ardhur shprehja **nëse** dhe jo **kur**, ngase një gjë e tillë është e paqëndrueshme dhe hipotetike, është çështje e rastit dhe ka mundësi të ndodhë. Prindërit ua duan të mirën fëmijëve të tyre, e ç’dobi më të madhe mund të ketë sesa njëzimi i Allahut dhe të jetuarit nën mbrojtjen e Krijuesit të Lartësuar?!

Shiko, *Allahu të pastë nën kujdesin e Tij!*, fjalën e Allahut të Lartësuar **orvaten**, respektivisht japin mund të madh e të vazhdueshëm për të të shmangur nga e vërteta dhe për të të çuar drejt mohimit. Një çështje e tillë rrallë ndodh nga ana e prindërve. Kufizimi i shfuqizimit të së drejtës së tyre në bindje me këtë gjendje të rrallë tregon se mbetet në fuqi e drejta e tyre në çështjet e tjera përveç besimit. Përmendja e dyjësit **“... ata dy orvaten...”** është argument se gjykimi është i njëjtë për të dy prindërit, pa marrë parasysh nëse kjo ndodh nga të dy në të njëjtën kohë apo nga ndonjëri prej tyre, gjykimi është i njëjtë.

Një rast i tillë i ka ndodhur Sad ibn Ebu Vekasit, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, kur e kishte përqaftuar Islamin. Nëna e Sadit ishte betuar se nuk do t'i fliste kurrë, derisa të hiqte dorë nga feja e tij, as nuk do të hante, as nuk do të pinte. Ajo i kishte thënë: “Ti pretendon se Allahu të porositi të sillesh mirë me prindërit. Ja, unë jam nëna jote dhe po të urdhëroj me këtë.” Sadi rrëfen: “Ajo qëndroi kështu tri ditë, derisa i ra të fikët nga lodhja. Djali tjetër i saj, i quajtur Imare, i jepte ujë për të pirë, ndërsa ajo bënte lutje kundër Sadit. Allahu zbriti këtë ajet **“Ne e kemi urdhëruar njeriun që t’i nderojë prindërit e vet”, “Nëse ata dy orvaten, që të më shoqërosh Mua (në adhurim) diçka”, “Por sillu mirë me ata në këtë jetë.”** (Shënon Muslimi)

Orvatja për t’i shoqëruar Allahut diçka në adhurim **“Nëse ata dy orvaten, që të më shoqërosh Mua (në adhurim) diçka, për të cilën ti nuk ke dijeni, mos i dëgjo”** ka sqarim lidhur me pezullimin e së drejtës madhore të prindërve në dëgjim. Përndryshe, në esencë mbetet e drejta e tyre. Madje, edhe në këtë situatë, shfuqizohet vetëm e drejta e dëgjimit në aspektin fetar dhe jo e drejta e mirësjelljes ndaj tyre në çështjet e kësaj jete, ngase ata po urdhërojnë diçka që kundërshton urdhrin e Allahut. E, ai që urdhëron diçka të tillë, nuk dëgjohej. I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: *“Nuk ka bindje (ndaj tjetrit) në mëkatim, por (bindja) është vetëm në gjërat e lejuara.”* (Shënon Buhariu)

Le të meditojmë fjalën e Allahut të Lartësuar: **“Mos i dëgjo”** se si është e kufizuar në mosdëgjim për çështjen

fetare, ngase i Lartësuar i nuk po thotë “Mos jini të mirës-jellshëm ndaj tyre” duke sqaruar të drejtën e madhe që kanë prindërit, edhe nëse e urdhërojnë fëmijën e tyre me këtë krim të madh. Prandaj, çështja ka të bëjë me themelin dhe bazën e fesë. Megjithëkëtë, Allahu ka urdhëruar vetëm mosdëgjimin e tyre, e nuk ka urdhëruar sjelljen e keqe ndaj tyre, as nuk ka urdhëruar që atyre t’u bëhet keq, sepse ata gëzojnë të drejta të shumta.

Me qëllim që të mos kuptohet se mosdëgjimi i tyre nënkupton lejimin e dëmtimit të tyre apo lejimin e neglizhencës ndaj tyre, Allahu i Lartësuar menjëherë pas kësaj thotë: **“Por sillu mirë me ata në këtë jetë.”**

Allahu na ka urdhëruar që me prindërit të sillemi mirë, edhe nëse nga ata vjen një çështje e ndjeshme si kjo. A thua, si qëndron puna nëse prindërit janë besimtarë dhe urdhërojnë për mirësi dhe ftojne drejt saj?!

Kufizimi i sjelljes së mirë në këtë jetë **“Por sillu mirë me ata në këtë jetë”** vjen pasi ata janë jobesimtarë, siç kuptohet nga konteksti. Prindërit jobesimtarë nuk do të takohen me fëmijën e tyre në botën tjetër. Ky kuptim i bukur i shfaqur në këtë porosi duke i shoqëruar prindërit me mirësi në këtë jetë, me ndryshimin fetar dhe këmbënguljen e tyre për ta shmangur fëmijën e tyre nga e vërteta, zbulon defektet e civilizimeve materialiste sot, që, për nënën, caktojnë vetëm një ditë për tërë vitin, ku fëmijët mund të pyesin apo edhe të mos pyesin fare për nënën e tyre dhe pas kësaj nuk ka as komunikim, as lidhje! Për nënën kanë caktuar një ditë në vit, 8 Marsin, për ta vizituar e për t’i çuar dhurata. Në këtë ditë, në

vendet perëndimore, fëmijët venë te nënat e tyre, qofshin edhe në shtëpi a azil pleqsh, apo ndonjë shtëpi të braktisur, tek jetojnë që nga vegjëlia, duke marrë me vete një trëndafil të bardhë apo ndonjë dhuratë të vockël e me buzëqeshje hipokrite. Me nënat rrinë ftohtë dhe me buzëqeshje sipas adetit, ndërsa për çdo minutë shikojnë orën, dhe shpejtojnë të largohen e ta lënë sërish të vetme e të vazhdojnë me shkëputjen e lidhjes dhe mungesë respekti, duke pritur vitin e ardhshëm. Disa nëna, të burgosura në shtëpitë në fjalë, kur qenë pyetur për dëshirën e tyre të vetme, të gjitha me një fjalë qenë përgjigjur: Vdekja!

Ah, sikur të meditonte njeriu këtë madhështi në fenë tonë! Të shikonte se si ruhen të drejtat e të pafuqishmëve, të moshuarve dhe të atyre që kanë merita ndaj nesh, madje edhe me dallime fetare! Mbetet e drejta e lidhjes familjare, e respektit dhe e furnizimit. Ndërkaq, në atë qytetërim të mjerë zhduken të gjitha të drejtat e atyre që janë të pafuqishëm, ngase, siç pretendojnë, prej tyre nuk ka kurrfarë interesi. Ibn Kajimi thotë: “Në bazë të argumenteve, kuptohet obligimi i furnizimit të tyre, edhe nëse u dallojnë fete, duke u mbështetur në fjalën e Allahut të Lartësuar: **“Ne e kemi urdhëruar njeriun që t’i nderojë prindërit e vet. Nëna e ka mbartur atë, duke duruar mundim pas mundimi, e ndarja e tij (nga gjiri) është brenda dy vjetësh. Ne i thamë atij: “Bëhu falënderues ndaj Meje dhe prindërve të tu! Tek Unë do të ktheheni të gjithë. Nëse ata dy orvaten, që të më shoqërosh Mua (në adhurim) diçka, për të cilën ti nuk ke dijeni, mos i dëgjo, por sillu mirë**

me ata në këtë jetë." Nuk është nder e as mirësi lënia e babait dhe nënës në kulmin e nevojave jetike, ndërkohë fëmija është në skajin e pasurisë. Allahu i Lartësuar i ka qortuar dhe kërcënuar ata që i shkëpusin lidhjet farefisnore, si dhe ka obliguar të drejtat e tyre edhe nëse janë jobesimtarë. Allahu thotë: **"Dhe frikësojuni Allahut, me emrin e të Cilit ju kërkoni të drejtat e ndërsjella dhe ruani lidhjet farefisnore."** (En Nisa, 1) Gjithashtu thotë: **"Sa për ata që shkelin besëlidhjen me Allahun, pasi janë zotuar për atë e, që këpusin lidhjet (familjare) që ka urdhëruar Allahu të ruhen."** (Er Rad, 25) Ndërkaq, në hadith thuhet: *"Kush i shkëput lidhjet me të afërmit, nuk do të hyjë në Xhenet."* Gjithashtu: *"Farefisnia qëndron e varur për Arshin (Fronin) dhe thotë: "O Allah, mbaji lidhjet me atë që i mban me mua dhe shkëputi me atë që i shkëput lidhjet me mua."*

Nuk konsiderohet mbajtje e lidhjes farefisnore lënie e të afërmeve të vdesin nga uria, etja dhe z bathja, ndërkohë i afërmi i tyre konsiderohet ndër njerëzit më të pasur. Mbajtja e lidhjeve farefisnore është obligim, qoftë edhe ndaj një jobesimtari, ngase ai mban fenë e vet, kurse mbajtësi i lidhjeve fenë e vet."

Kjo është feja jonë madhështore, këto janë mësimet e kësaj feje. Në Holandë, këto ditë, diskutojnë idenë e eutanazisë (vrasjes së mëshirshme), respektivisht lejimin e vetëvrasjes së të moshuarve përmes një shiringe të veçantë. Holanda, në vitin 2009, ka regjistruar 2500 raste të këtij lloji të vrasjes, me një rritje prej 10% nga vitet e kaluara.

Të atilla janë mësimet e qytetërimeve të tyre, kurse këto janë mësimet e fesë sonë. A arritëm të kuptojmë këtë dhe ta ndiejmë krenarinë që i përkasim kësaj feje madhështore?!

Nga ajo që u tha më sipër, na u shfaq ekuilibër madhështor lidhur me sjelljen me prindërit në përgjithësi, si dhe mënyrën e sjelljes me ta në situata të veçanta kur nuk duhet t'u bindemi atyre për çështjet e fesë.

Po të shikonim me vëmendje udhëzimin hyjnor pas kësaj, do të gjenim se kemi një ndalesë dhe dy urdhra. Sa i përket ndalesës, ajo është: **"... mos i dëgjo..."**, kurse dy urdhrat janë: **"... por sillu mirë me ata në këtë jetë dhe ndiq rrugën e atij që drejtohet tek Unë."**

Kësisoj realizohet ekuilibri dhe ruajtja e të drejtave. Ajo që kërkohet është sjellja e mirë me ta e nuk kërkohet ndjekja e rrugës së tyre, por ata duhet të ndjekin ata që i sjellin dobi njeriut në fenë e tij. Nga njëra anë, ai sillet mirë me prindërit e vet në mënyrë që të kryejë obligimin ndaj tyre, edhe nëse ata janë jobesimtarë, si dhe, në anën tjetër, e ruan fenë e tij duke u shoqëruar me besimtarë të devotshëm e të drejtuar tek Allahu, ashtu siç thotë Allahu i Lartësuar: **"Dhe ndiq rrugën e atij që drejtohet tek Unë."** Sjellje e mirë me prindërit dhe ndjekje e fesë së Allahut. Me këtë harmonizim madhështor rregullohet jeta, përgëzohet njeriu si dhe ecën sipas udhëzimit dhe dritës.

Ajeti përmbillet me kërcënimin dhe rikujtimin e fundit: **"Pastaj, tek Unë do të ktheheni dhe Unë do t'ju lajmëroj për atë që keni bërë."**

Prandaj, kush beson në kthimin dhe ringjalljen tek i Gjithëdijsmi dhe Gjithinformuari, nuk ka dyshim se nuk do t'i humbasë ato të drejta, nuk do të ecë në tokë pa udhëzim. Atij që beson se veprat i ka të kufizuara, fletushka do t'i jepet ashtu siç thotë Allahu i Lartësuar: **“Unë do t’ju lajmëroj për atë që keni bërë.”** Ai do të kujdeset në këtë jetë për t’i kryer të drejtat e për të punuar vepra të mira, si dhe për t’u larguar nga të këqijat. Vërtet, këto janë udhëzimet hyjnore, inspirimet qiellore, që kanë nevojë për zemra të gjalla dhe shpirtra të çiltër, në mënyrë që t’i shndërrojnë ato në realitet të qartë e të prekshëm.

POROSIA E KATËRT

MBIKËQYRJA E ALLAHUT

“O djali im, edhe veprën e rëndë sa kokrra e sinapit që ndodhet në shkëmb, në qiej apo në tokë, Allahu do ta nxjerrë në shesh. Me të vërtetë, Allahu njeh mirë çdo imtësi dhe i di të gjitha fshehtësitë.”

Kjo pjesë e porosisë së besimit dhe edukatës nis me përsëritjen e thirrjes së butë **O djali im**, gjë që aludon dashurinë, që është afruese për zemrat, treguese e dhembshurisë, krahas paralajmërimit rreth rëndësisë së asaj që pason në vijim.

Në këtë pjesë të porosisë Lukmani i tërheq vërejtjen të birit rreth një çështjeje madhore, që edukon zemrën dhe kontrollon ndërgjegjen. Ai assesi nuk ka thënë se, im bir është i vogël e nuk i koncepton këto domethënie. Por, që nga fillimi e edukon mbi mbikëqyrjen e Allahut. E njohu me Zotin e tij, të Cilit nuk i fshihet asgjë, edhe nëse ajo është sa një kokërr e vogël në këtë univers madhështor.

Me të vërtetë, me lejen e Allahut, një udhëzim i tillë krijon mbikëqyrje të brendshme, formon përmbajtje subjektive nga devijimi dhe mëkati. Kushdo që mendon se mbikëqyrja e prindërve ditën e natën është ajo që garanton përmirësimin e tyre, ka mendim të gabuar. Përcjellja e tyre konsiderohet e rëndësishme, mirëpo kryesore mbetet zemra dhe ndërgjegjja. Cilën ua ke ofruar atyre, o prind? Cilën ia ke kultivuar fëmijës tënd?

Frikën nga ti apo frikën nga Krijuesi? Ka frikë prej teje apo prej Allahut?

Dallimi është i madh. Ai që i vëzhgon vetëm krijesat, të këqijat i bën në mospraninë e tyre, kurse ai që në ndërdije ka vëzhgimin e Allahut, i frikësohet Allahut në çdo vend. Kur një burrë qe vetmuar me një femër, siç qëndron në hadithin e të ngjuarve në shpellë, çfarë e kishte ndalur që të mos bënte imoralitet përveçse mbikëqyrja e Allahut?! Në hadith thuhet: *“E kam pasur një kushërirë të afërme, e doja më shumë se gjithë botën, andaj kërkova prej saj (atë që kërkojnë burrat prej grave të tyre), por ajo nuk pranoi. Kështu, një vit mbretëronte uria, ndërkohë kushërirë që dashuroja më erdhi dhe unë i dhashë 120 dinarë (monedha ari), që të vetmohej me mua, gjë të cilën e pranoi, kështu që unë u bëra pronar i saj, porse ajo (duke qarë) më tha: “Frikësoju Allahut e mos ma merr virgjërinë padrejtësisht.” Atëherë iu largova dhe e kurseva nga akti i turpshëm, edhe pse e doja më shumë se çdokënd tjetër. E lashë të lirë dhe ia fala të hollat që ia pata dhënë.”* (Shënon Buhariu)

Vallë, çfarë e kishte paralajmëruar zemrën e kësaj gruaje dhe çfarë e kishte shtyrë të vetëpërmbahej këtë burrë? Thjesht, mbikëqyrja dhe madhërimi i Allahut.

Përsiat te Merjemja kur i kishte vajtur Xhibrili në formën e njeriut e me moral të bukur: **“Ajo i tha: “Unë kërkoj që të më mbrojtë i Gjithëmëshirshmi prej teje, nëse i frikësohesh Allahut.”** (Merjem, 18)

Kujto tërë këtë situatë duke sjellë ndërmend ato fjalë madhështore me të cilat Lukmani e këshillon të birin e tij kur i thotë: **“O djali im, edhe veprën e rëndë sa kokrra e sinapit”**, respektivisht mëkati dhe gjynahu, ose çdo gjë tjetër e vogël, e për të cilën njeriu mendon se mund të fshihet, qoftë edhe sa kokrra e sinapit, gjë e cila është diç fare e vogël, edhe në qoftë se është në shkëmb, respektivisht, në brendinë e shkëmbit, në mes apo edhe i ndarë në dysh, vërtet Allahu e di.

Allahu ka përmendur kokrrën e sinapit, që konsiderohet ndër gjërat më të imëta e më të vogla, përkundër faktit se ndodhet në shkëmbinj, që janë ndër gjërat më të forta, më ekstreme dhe më të përhapura e me llojllojshmëri të madhe, megjithëkëtë Allahu e di. Nga kjo vetëkuptohet se dija mbi gjërat që janë më të dukshme se ajo kokërr është më primare. Sa dije madhështore e Allahut! Sa fuqi madhështore e Tij! Sa i padijshëm që është njeriu dhe sa i kufizuar është shikimi i tij!

Allahu i Lartësuar thotë: **“Ai i ka çelësat e së padukshmes dhe vetëm Ai i njeh ato. Ai e di ç’ka në tokë dhe në det; asnjë gjeth nuk bie, pa e ditur Ai dhe nuk ekziston asnjë kokërr në errësirën e tokës, as e njomë, as e thatë, që të mos jetë shënuar në Librin e qartë (Leuhi Mahfudh).”** (El Enam, 59)

E si është e mundur, pas gjithë kësaj, që shikimin e njerëzve ta konsiderojmë më të rëndësishëm se shikimin e Allahut, t’u frikësohemi njerëzve e të mos i frikësohemi Atij, të turpërohemi prej tyre e të mos turpërohemi prej të Lartësuarit? Disa nga gjeneratat e para kanë thënë: “Mos e shiko vogëlsinë e mëkatis, por shikoje

madhështinë e Atij që i mëkaton.” Gjithashtu është thënë: “Mos e konsidero Allahun thjesht dikush që të sheh!”

Kaloi rinia e s'mund të kthehet, erdhi pleqëria e s'ke ku shkon?

Lëre atë që iku në rini, kujto mëkatet e vajto për to, o ti që mëkaton.

Kujto Ditën e Llogarisë, ngase do të regjistrohet çdo gjë që ke vepruar.

Dy engjëjt nuk do t'i harrojnë veprimet e tua, edhe nëse ti i ke harruar.

Mirëpo ata i konfirmojnë ato, ndërkohë ti ke vazhduar duke i shpërfillur.

Shpirti të është lënë amanet, andaj do ta kthesh, edhe po t'u duk gjë e hidhur.

Mashtrimet e kësaj jete, pas të cilave vrapon, janë kënaqësi që harrohen.

Dije se edhe frymëmarrjet, që i bëjmë ditë e natë, do të numërohen.

Sa mirë do të ishte po të mbilleshin në zemrat e të rinjve këto domethënie të bukura, në mënyrë që ta vlerësojnë Allahun ashtu siç e meriton!

Le të mendojmë mbi metodologjinë e kultivimit të këtyre kuptimeve si kanë ardhur, duke tërhequr vëmendjen te

pushteti i Allahut, që është çështje e prekshme, e dukshme dhe e rrokshme. A kemi vepruar ne kësisoj? A kemi shfrytëzuar ekskursionet e shëtijet për të tërhequr vëmendjen e fëmijëve tanë lidhur me gjithëpushtetin dhe gjithëfuqinë e Tij përgjatë maleve të larta, luginave të pafundme, bimëve plot gjallëri e tokave të gjera? Sa fushë e gjerë që është, po të mendonim për këtë! Ç’pasuri mbi besimin, sikur të meditonim për këtë! Njohuritë nuk na mungojnë, por në zemra na mungon madhërimi i të Madhërishmit dhe vlerësimi i fuqisë së Allahut ashtu siç i takon.

Një natë një burrë ishte vetmuar me një femër dhe kishte vërejtur se ajo qe tronditur dhe frikësuar për këtë, ndaj e kishte pyetur: “Nga ç’gjë frikësohesh? Nuk gjendet askush përveç nesh, në përjashtim të yjeve. Ajo, me një zemër të gjallë, që i rrahu kur pa madhëstsinë dhe krijimin e jashtëzakonshëm të Allahut, i tha: “Po Krijuesi i yjeve, ku është?” Në këtë rast burri përsiati dhe e la atë e iku.

Apo rasti kur një gruaje tjetër i qe thënë: “Janë mbyllur të gjitha dyert (e s’na sheh askush për t’i bërë mëkat Zotit)”, me ç’rast ajo ia kishte kthyer: “Po dera e Allahut?” Atëherë burri ishte frikësuar dhe e kishte lënë.

Ky është edukimi i zemrës, i cili është më se i nevojshëm të përqendrohet te fëmijët tanë, sepse rezultatet e tij do të jenë të përhershme. Ndërkohë, shumë edukatorë i kushtojnë kujdes aspektit të jashtëm dhe sjelljes

sipërfaqësore, e nuk interesohen në edukimin e zemrës, ndaj e shpërfillin këtë. Vini re kujdesin e Lukmanit për këtë çështje: i kishte dhënë përparësi kundrejt sjelljes së dukshme, sepse ajo është më e rëndësishme. **“O djali im, edhe veprën e rëndë sa kokrra e sinapit që ndodhet në shkëmb, në qiej apo në tokë, Allahu do ta nxjerrë në shesh.”**

Medito mbi këtë avancim në madhërim dhe nderim. Nëse ky djalosh tashmë ka arritur disa njohuri rreth shkëmbit, që e ka afër, dhe ka njohuri rreth fuqisë së Allahut, a thua çfarë do të jetë gjendja e tij kur të zgjerohet fusha e asaj njohurie gjersa të përfshijë qiejt madhështorë, tokën e gjerë? Pa dyshim, ai do ta kuptojë edhe më shumë madhështinë e Zotit të tij, i Cili përfshin çdo gjë.

Shiko se si është vonuar përmendja e Krijuesit të tërë kësaj, e që është Allahu, deri në fund të fjalisë: **“Allahu do ta nxjerrë në shesh”**, në mënyrë që të jetë më nxitëse, për të mësuar kush qenka Ai që i poseduaka këto cilësi. Kur fëmija të dëgjojë fillimin e ajetit **“Edhe vepra e rëndë sa kokrra e sinapit”**, vijuar nga gjëra më të mëdha, si: shkëmbi qiejt dhe Toka, pyet: **“Ç’është puna e tyre?”** Përgjigjja vjen: **“Allahu do ta nxjerrë në shesh.”** Me këtë rast ngulitet madhërimi i Allahut në zemër. E, kur të arrihet kjo, realizohet mbikëqyrja dhe vendosmëria. Ai që bindet në këtë, gjithashtu bindet se të gjitha veprat e tij janë të kufizuara, të numëruara e të shënuara, ashtu siç

thotë Allahu: **“Allahu të gjitha i ka shënuar, edhe pse ata i kanë harruar.”** (El Muxhadile, 6)

Ji me Krijuesin tënd madhështor në kuadër të kësaj bindjeje dhe kujto fjalën e Tij: **“Dhe në Ditën e Kiametit, Ne do të vendosim peshore të sakta e askush nuk do të pësojë asnjë padrejtësi. Ne do të sjellim (për gjykim) çdo vepër, qoftë kjo edhe sa pesha e një kokrrë sinapi. Ne jemi të mjaftueshëm për llogaritje.”** (El Enbija, 47)

Ç’kuptim madhështor e fisnik! Sa të pavëmendshëm që jemi ndaj këtij kuptimi! Sa e sa argumente na rrethojnë, mirëpo ne kemi mbyllur të dëgjuarit e të shikuarit tonë: as dëgjojmë, as shohim. Këtë univers të pafund bëje këshillues të zemrës, kujtues të Zotit tënd, ngase kësisoj ngjallet zemra dhe lumturohet shpirti.

Ky ajet përmbillet me dy nga emrat më të bukur të Allahut, që janë: i Buti dhe i Mirënjohuri (me dije të thellë për çdo imtësi). Sa të nevojshëm që jemi për t’ua kuptuar domethëniet këtyre emrave, për ta adhuruar Allahun sipas tyre! Ndërsa lexojmë fjalën e Allahut dhe hasim ndonjë prej emrave të Tij të bukur, të ndalemi për ta medituar. Le t’ia shpalosim jetën dhe veprat tona domethënieve të atyre emrave, ngase vetëm atëherë secili prej nesh do të mësojë ku gjendet dhe ç’është puna e tij. Shiko se si është përmbyllur kjo këshillë me këta dy emra: I Buti (Bamirës i pakufi) dhe i Mirënjohuri (me dije të thellë për çdo imtësi), si dhe shiko lidhshmërinë e tyre me këtë ajet: **“Shikimet njerëzore nuk mund ta arrijnë Atë, ndërkohë që Ai i arrin shikimet e të gjithëve. Ai është Bamirës i pakufi dhe di çdo gjë.”** (El Enam, 103)

El Latif është Ai, krijimtaria e të Cilit është lehtësuar dhe është përsosur, sa që të kuptuarit është i mangët për ta konceptuar, ndërsa *el Habir* është Ai, Dija e të Cilit përfshin çdo imtësi dhe hollësi. I Lartësuar qoftë Zoti ynë, sa cilësi fisnike që ka, e, në anën tjetër, sa të paditur dhe të pavëmendshëm që jemi ne! Zoti ynë i dëgjon fjalët dhe pëshpëritjet tona, i sheh veprat tona, kurse ne mendojmë se i jemi përvjedhur mbikëqyrjes së Tij. Sa i paditur, i pavëmendshëm, i pafuqishëm dhe mohues që është njeriu!

Aishja, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, thotë: “I Madhëruar qoftë Ai, dëgjimi i të Cilit i përfshin zërat! Betohem në Allahun se një grua, që ankohej për burrin e saj, erdhi tek i Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selam*, ndërsa unë isha në këndin e dhomës, ndaj nuk i dëgjoja mirë fjalët e saj, kurse Allahu e dëgjoji gruan nga sipër shtatë qiejve dhe zbriti fjalët: **“Allahu i ka dëgjuar fjalët e asaj, që diskutoi me ty për burrin e vet dhe iu ankua Atij. Allahu e dëgjoji bisedën tuaj, sepse Ai dëgjon dhe sheh gjithçka.”** (El Muxhadile, 1)

Prandaj, edukoje veten dhe fëmijën tënd mbi kuptimet e këtyre domethënieve madhore. Shiko metodologjinë e Lukmanit në këshillën drejtuar djalit të tij, si është kujdesur për këtë çështje si e ka ngritur, duke i vënë në theks djalit të tij disa përforcime, si: thirrja (o djali im), pastaj përforcueset *inne* e *inneha*, e gjithë kjo për shkak të rëndësisë së kësaj çështjeje dhe rrezikun e saj. Po ti, a vepron kësisoj?

Te fëmija yt fillo me tërheqjen e vëmendjes duke ia kujtuar pushtetin e Allahut dhe gjerësinë e madhe të këtij

pushteti, fuqinë dhe urtësinë e Tij. Kujtoji ajetet e kësaj natyre: **“Sido që të flisni ju, fshehtas apo haptas, Ai e di mirë ç’ka në zemrat tuaja. E si të mos dijë Ai që ka krijuar gjithçka, kur Ai njih çdo gjë me imtësi dhe është i Gjithinformuari?!”** (El Mulk, 13-14)

Ibn Kajimi, në librin e tij *Reudatul muhibine*, ka përmendur se një burrë kishte hyrë në një zabel e kishte thënë: “Nëse vetmohem në këtë vend për të mëkatuar, kush do të më shohë? Atëherë kishte dëgjuar një zë që përfshiu tërë zabelin: **“E si të mos dijë Ai që ka krijuar gjithçka, kur Ai njih çdo gjë me imtësi dhe është i Gjithinformuari?!”**

Disa nga gjenerata e parë kanë thënë: “Atij që posedon këshillues nga zemra, Allahu ia shton krenarinë.”

Nëse vetmohesh për të vepruar diç të dyshimtë në errësirë dhe epshi të nxit për të mëkatuar, turpërohu nga shikimi i Allahut dhe thuaj se më sheh Ai që ka krijuar errësirën.

POROSIA E PESTË

NAMAZI

“O djali im, kryeje namazin, urdhëroje të mirën, pengoje të keqen dhe bëhu i durueshëm për çfarëdo që të godet! Me të vërtetë, ky është thelbi i patundur i të gjitha punëve!”

Këtu po ripërsëritet thirrja e butë “O djali im”, ngase ajo për të cilën urdhërohet në vijim konsiderohet çështje e

rëndësishme, çështje madhore dhe e ndjeshme, që ka nevojë për kujdes dhe tërheqje të vërejtjes. Këtu Lukmani urdhëron djalin me kryerjen e namazit, me urdhërimin për të mirë dhe pengimin e së keqes, njëherazi e urdhëron të jetë i durueshëm për çfarëdo që e godet.

Sikur t'i meditonim këto tri çështje, do të vërenim se kemi të drejtën e Allahut, që është namazi, dhe kjo ka lidhshmëri me fillimin e porosisë që tregon për madhërimin dhe nderimin e Allahut. Sikur na shfaqet një portret lidhur me këtë, e që është namazi. Përfshin edhe të drejtën e njerëzve duke u sjellë atyre dobi e duke i udhëzuar drejt të dobishmes, si dhe duke i larguar nga e dëmshmjia, që është e drejtë e përgjithshme, renditur pas së drejtës së prindërve, që konsiderohet e veçantë. Përfshin edhe të drejtën e shpirtit, që është durimi. Durimi konsiderohet armë e fortë për t'i realizuar këto virtyte. Këto tri aspekte i përmbledh një çështje tjetër, që është vështirësia. Prandaj, durimi ndaj tyre konsiderohet thelbi i çështjes. Babai doemos duhet të tregojë kujdes në kalitjen e kësaj çështjeje te fëmija. Këto aspekte, gjithashtu, konsiderohen thelbi i punëve të mira, ngase janë përmendur pas mësimit të çështjeve themelore të besimit. Kundroje mirë këtë sistem gjatë edukimit dhe kujtoje gjithnjë gjatë udhëzimit fëmijën tënd.

Namazi, që është përmendur i pari, ka ngarkesë dhe vështirësi që i referohet përsëritjes së vazhdueshme. E kush mund të jetë i durueshëm në këtë? Namazi, po

ashtu, vjen edhe gjatë kohës kur njeriu ndoshta dëshiron të pushojë. E si do t'i bëjë ballë kënaqësisë së pushimit kur vjen në shprehje kryerja e obligimit? Ajo që kërkohet është përgjigjja ndaj thirrjes së Allahut për namaz dhe vazhdueshmëria e një gjëje të tillë. Prandaj, kur dëgjojmë thirrjen për namaz, neve na është ligjësuar t'i përsërisim fjalët e myezinit dhe t'i shqiptojmë shprehjet që thotë ai, përveç kur myezini thotë *Haje ales salah*, dhe *Haje alev felah* (Eja në namaz, eja në shpëtim) që konsiderohen thirrje e qartë për namaz, me ç'rast themi *La haule ue la kuvete il-la bil-lah* (Nuk ka lëvizje e as forcë pa dëshirën e Allahut). Fshehtësia e kësaj qëndron në faktin se ajo paraqet ngarkesë dhe vështirësi, andaj kemi nevojë për ndihmën e Zotit. Ne nuk mbështetemi në ndryshimin dhe forcën tonë, ndaj çështjen ia dorëzojmë Allahut të Lartësuar, në mënyrë që të na ofrojë ndihmë në këtë. Shejhul-islami, Ibn Tejmija, thotë: "Thënia *La haule ue la kuvete il-la bil-lah* (Nuk ka lëvizje e as forcë pa dëshirën e Allahut) detyron ndihmën, prandaj Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka ligjësuar që, kur myezini të thotë *Haje ales salah* (Eja në namaz), dëgjuesi të thotë *La haule ue la kuvete il-la bil-lah* (Nuk ka lëvizje e as forcë pa dëshirën e Allahut). Njashtu, kur (myezini) të thotë *Haje alev felah* (Eja në shpëtim), ai thotë të njëjtën *La haule ue la kuvete il-la bil-lah* (Nuk ka lëvizje e as forcë pa dëshirën e Allahut).

Et Tibiu thotë: "Kuptimi i këtyre thënieve është: Eja dhe drejtohu me fytyrën dhe brendinë tënde drejt udhëzimit,

herët e shpejt (në këtë botë), kurse me fitimin e mirësive në botën e përtejme. Prandaj, është e përshtatshme të thotë: “Kjo është çështje madhore, unë me pafuqinë time nuk mund ta kryej, përveç nëse Allahu më ndihmon dhe më jep sukses me fuqinë e Tij.”

Hoxhë Atije Salimi thotë: “Dijetarët, lidhur me domethënien e kësaj shprehjeje, deklarojnë: Nuk ka fuqi për t’u larguar nga mëkati, e as për t’iu bindur Atij, përveçse përmes (ndihmës së) Allahut. Kjo konsiderohet baza e njëzimit (teuhidit). Njeriu është i dobët përballë mëkatit, ngase egoja, tekat, djalli dhe pasionet, që të gjitha këto janë faktorë që e nxisin drejt mëkatit. Si ka mundësi që të gjithë këta faktorë të bashkërenduar t’i largojë pa ndihmën e Allahut të Lartësuar. Rrjedhimisht, edhe nënshtrimin ndaj urdhrave mund ta bëjë vetëm përmes Allahut.”

Një koncept të tillë fisnik patjetër duhet ta kuptojë e ta ndiejë besimtari, madje gjeneratat e reja duhet të edukohen në dritën e këtij kuptimi, në mënyrë që kjo t’u ndihmojë në këtë obligim madhor, në vend të ankimit nga ky adhurim fisnik.

Lukmani e nisi këshillën e tij me namaz, ngase është shtylla e të gjitha punëve të mira. I Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “*Kreu i çështjes është Islami, shtylla e saj është namazi, maja e ngrehinës së të cilës është xhihadi (në rrugë të Allahut)..*”¹, kjo, ngaqë

¹ Shënon Ibn Maxhe, saktëson Albani.

namazi përfshin nënshtrimin dhe dorëzimin maksimal ndaj Allahut të Lartësuar. Namazi përfshin ditën dhe natën e njeriut, e më pas edhe jetën e tij. Porosinë e filloi me atë vepër me të cilën njeriu është më shumë i lidhur dhe që i përsëritet, që të adaptohet me të dhe t'i lehtësohet kryerja e saj, ngase kjo vepër vazhdimisht e mban njeriun të lidhur me Krijuesin e vet.

Lukmani urdhëroi kryerjen e namazit dhe jo të vetë namazit, siç i thotë: **“Kryeje namazin”**, e nuk i tha **“Falu”**, ngase *kryerja e namazit* nënkupton vazhdimësinë dhe kujdesin për të në kohë të caktuara, sikur që nënkupton edhe kryerjen e namazit në formën më të përsosur, duke respektuar shtyllat, obligimet dhe veprimet e preferuara gjatë namazit. Bëhet thirrje për përsosuri të namazit në kohë dhe mënyrë, ngase vetëm kështoj i pranohet namazi, e nuk është për qëllim thjesht lëvizjet dhe formalitetet. Bazuar në këtë, në Kuran të gjitha urdhrat që ndërliken me thirrjen për namaz kanë ardhur me shprehjen ‘kryerja e namazit’. Allahu nuk ua ka pranuar hipokritëve formalitetin e namazit, ngase ata kanë humbur shpirtin e tij (namazit), e që është sinjeriteti për Allahun e Lartësuar dhe ndjenja e Madhështisë së Tij. Allahu i ka qortuar hipokritët, ku përkitazi me ta thotë: **“Në të vërtetë, hipokritët përpiqen të mashtrojnë Allahun, por është Ai që i mashton ata. Kur ata ngrihen për namaz, ngrihen me përtesë, vetëm sa për t’u dukur para botës dhe Allahun e përmendin fare pak.”** (En Nisa, 142)

Ndërkaq, lidhur me besimtarët thotë: **“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përlulur në namazin e tyre”** (El Muminun, 1-2)

Namazi konsiderohet ndër shkaqet më të mëdha të qetësisë. Kur të të mërzitet zemra, kur të të preokupohet dhe të të mërzitet shpirti, nxito në namaz dhe kujto thënien e të dashurit tënd, Muhamed Mustafasë, *sal-lallahu alejhi ue selem*, lidhur me namazin: *“O Bilal, thirre ikametin për namaz, e na qetëso me të!”*¹ Sahabët thoshin: *“Kur të Dërguarin, sal-lallahu alejhi ue selem, e shqetësonte ndonjë gjë e madhe, nxitonte të falte namaz.”* Fëmija që edukohet mbi parimet e këtyre koncepteve, arrin të kuptojë rëndësinë e namazit dhe kujdeset vetvetishëm për të.

Përkundër asaj që u tha më sipër, shumë prindër ankohen për moskujdesin e fëmijëve të tyre ndaj namazit, veçanërisht kur ata të rriten. Kjo është një çështje e dukshme dhe e sikletshme për shumë prindër. Në vijim do të orvatemi t’i sjellim disa hapa praktikë për trajtimin e kësaj çështjeje:

Së pari: Duhet të stolisesh me durim, ngase për të realizuar një kërkesë të tillë kërkohet shumë durim. Mos i përshpejto frytet, por kujto fjalën e Allahut të Lartësuar drejtuar profetit Muhamed, *sal-lallahu alejhi ue selem*: **“Urdhëroje familjen tënde që të falë namazin dhe këmbëngul për këtë! Ne nuk të kërkojmë ty ndonjë**

¹ Shënon Ebu Daudi, saktëson Albani.

ushqim: jemi Ne që të ushqejmë! Përfundimi i lumtur qëndron në frikën ndaj Allahut.” (Taha, 132)

Shiko se si thotë Allahu i Lartësuar **këmbëngul**, e nuk thotë **duro**, për shkak të vështirësisë dhe mundit të madh që duhet dhënë. Mos të të mundë dëshpërimi e as humbja e shpresës.

Së dyti: Kujdesi gjatë fazës së imitimit te fëmijët. Ki kujdes gjatë fëmijërisë së hershme, ndërmjet moshës tre- dhe gjashtëvjeçare, lëri të të qëndrojnë pranë gjatë namazit dhe të të imitojnë. Kjo konsiderohet ndër shkaqet më të rëndësishme të mbjelljes së dashurisë ndaj namazit në zemrat e tyre. Prandaj, babai duhet t’i falë namazet vullnetare (nafile) në prani të fëmijëve në një vend të dukshëm në shtëpi, në mënyrë që t’i mësojë e të familjarizohen me këtë adhurim. Të mësuarit në vegjëli është si gdhendja në gur. Është transmetuar nga Hasan el Basriu të ketë thënë: *“Na i sillni të vegjlit tuaj, pasi ata i kanë zemrat të zbrazëta (të pastra) dhe mësojnë më mirë atë që dëgjojnë.”*

Së treti: Nxitja, inkurajimi dhe shpërblimi i fëmijëve për shkak të kryerjes së namazit kur ata janë mes moshës shtatë- e dhjetëvjeçare, si dhe të qenët i sinqertë me ta. I Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: *“Urdhëroni fëmijët tuaj për (të falur) namaz kur t’i kenë*

shtatë vjet, e kur t'i bëjnë dhjetë vjet detyroni me forcë (rrihni) dhe ndajini në shtretër."¹

Së katërti: Kujdesi i vazhdueshëm ndaj namazit, gjë që bën t'u skalitet vlera, rëndësia dhe pozita e tij në zemrat e fëmijëve. Nënata t'i përcjellin fëmijët në kryerjen e namazit e t'i pyesin rreth tij, edhe nëse babai është në udhëtim. Të kërkojë përgjegjësi prej tyre, ngase qëllimi i tërë kësaj është që t'ua bëjë me dije rëndësinë e namazit. Njëherazi, formë e kujdesit ndaj namazit është edhe ndërlihdja e të gjitha kohëve me namaz, ashtu që biseda gjithnjë të bëhet rreth namazit. Njashtu, shoqërimi i tyre në xhami, duke ua mësuar etikën e xhamisë, duke i pozicionuar pranë teje më qëllim që të mos bëjnë veprime të pahijshme e t'i shqetësojnë falësit e tjerë.

Së pesti: Shëmbëlltyra e mirë. Kur fëmijët shohin dhe ndiejnë kujdesin e prindërve rreth namazit, kjo do të përcillet edhe tek ata, qoftë edhe pas një kohe. Ndaj, fëmijët patjetër duhet ta ndiejnë vlerën e namazit te prindërit. Kjo manifestohet duke ndërprerë punët kur të vijë koha e namazit, të nxituarit për ta falur namazin, të përgatiturit për të, si dhe kompensimi i namazit në rast të moskryerjes së tij.

Së gjashti: Shfrytëzo raste të ndryshme për t'ua kultivuar vlerën e namazit. Kur të sëmuret ndonjë prej fëmijëve, mësoja mënyrën e faljes së namazit paralel mundësive, si

¹ Shënon Ebu Davudi dhe thotë se ky hadith është hasen sahih.

dhe shpjegoja nevojën për Zotin që ta shërojë nga sëmundja. Kur të udhëtosh me fëmijët, mësojua mënyrën e faljes së namazit për udhëtarët dhe dispozitat përkatëse. Angazhoje njërin djalë ta thërrasë ezanin e tjetrin t'u dalë imam në namaz. Rrjedhimisht, do të vëresh se namazi gjithnjë do të jetë aktual në çdo kohë.

Së shtati: Ki parasysh se, nëse i praktikon ato që u thanë më lart, nëse tregohesh i durueshëm dhe i përkushtuar, fëmija yt do të jetë i përgatitur për moshën e pjekurisë, moshë kjo nga e cila fëmija do të merret në llogari për namazin. Kur fëmija ta arrijë këtë, duhet të ulesh me të, ta këshillosh me butësi, jo gjatë kohës kur je i zemëruar, siç vëmë re metodologjinë e Lukmanit me djalin e tij. Mësoje atë se që atëherë ai do të merret në llogari dhe se është përgjegjës për veprimet dhe sjelljet e tij. Kjo është më e dobishme sesa vëzhgimi i tij pandërprerë, që nuk sjell rezultatet e pritura. Rikujtoje gjithnjë me atë metodologji që ai nuk e bën atë të ndihet i nënçmuar, as duke e sfiduar, as duke e kontrolluar. Shfaqja dashurinë dhe vlerësimin, kështu do ta bësh për vete dhe do të kesh ndikim tek ai. Dije se çështja kryesore është në etapat paraprake. Nga moshja shtatëvjeçare e deri në moshën e pjekurisë fëmija yt ka falur afërsisht pesëmbëdhjetë mijë namaze. Kjo është një shifër e madhe dhe, siç e vëren, është e vështirë për atë që mësohet me lënien e një pune. Fillo e mos u brengos dhe bëj atë që ke mundësi. Mos harro lutjen e përhershme për përmirësimin e fëmijëve, ngase është lutje e pranuar. Ndërkaq, nëse ai

nuk praktikon atë që ti do, kujto fjalën e të Lartësuarit për Profetin, *sal-lallahu alejhi ue selem*: **“Vërtet, ti (Muhamed) nuk mund të udhëzosh kë të duash, por është Allahu Ai që udhëzon kë të dëshirojë. Ai i njeh më mirë ata që janë të udhëzuar.”** (El Kasas, 56)

Ne, ndonëse ankohe mi për braktisjen e xhamive dhe mospraninë e të rinjve për namaz, megjithatë duhet të mbështetim dukuritë pozitive të të rinjve që kujdesen për namazin në një formë të paparë më herët. Vërejmë tek falin namazin me xhemat bashkërisht nëpër stadione, në rrugë, gjatë udhëtimit, në tokë e në det. E tërë kjo pa një kontroll apo inkurajim të drejtpërdrejtë, gjë e cila, pa dyshim, është sukses i madh. Është thjesht një pjesë e gjurmëve të mira të një edukimi sistematik nëpër shtëpitë e shkollat tona për këtë adhurim.

POROSIA E GJASHTË

URDHËRIMI PËR TË MIRË DHE NDALIMI NGA E KEQJA

“O djali im, kryeje namazin, urdhëroje të mirën, pengoje të keqen dhe bëhu i durueshëm për çfarëdo që të godet! Me të vërtetë, ky është thelbi i patundur i të gjitha punëve!”

Lukmani, pasi e urdhëroi të birin me kryerjen e namazit, që quhet shtylla e fesë, e urdhëroi atë të urdhëronte në të mirë dhe të ndalonte nga e keqja, që, me lejen e Allahut, konsiderohet anije shpëtimi. Ai i tha: **“... urdhëroje të mirën, pengoje të keqen...”** Urdhërimi për

të mirë dhe pengimi nga e keqja është adhurim madhështor. Pikërisht, në saje të këtij virtyti, umeti e kishte arritur epitelin e të qenit populli më i mirë. Allahu i Lartësuar thotë: **“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun.”** (Ali Imran, 110)

Për shkak të madhësisë dhe kujdesit, në këtë ajet kuranor urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja është paraprirë kundrejt përmendjes së besimit, që është baza e fesë.

Urdhërimi për të mirë dhe pengimi i së keqes është simbol i efikasitetit të kësaj bashkësie, që gjithnjë përpiqet për përmirësim dhe mirësi. Umeti islam nuk është një bashkësi indiferente: të shohë të keqen e të heshtë ndaj saj. Ajo bashkësi që mbyll sytë kundrejt gabimeve dhe u nënshtrohet devijimeve, pa dyshim se dobësohet dhe ligështohet. Allahu i Lartësuar thotë: **“Vërtet, Allahu e ndihmon këdo që e ndihmon Atë. Allahu është vërtet i Fortë dhe i Plotfuqishëm. (Allahu i ndihmon edhe) ata, të cilëve, nëse u japim pushtet në tokë, kryejnë faljet, japin zekatin, urdhërojnë kryerjen e veprave të mira dhe pengojnë atë që është e mbrapshtë. Tek Allahu është fundi i të gjitha çështjeve.”** (El Haxh, 40-41)

Urdhërimi për të mirë e ndalimi nga e keqja nuk janë thjesht urdhra të dhënë e ndalesa të bëra, por është

metodologji e reformimit dhe përmirësimit, tek bën pjesë çdo reformator, udhëzues, thirrës në të mirë e në vlera, si dhe çdo paralajmërues nga e keqja, dëmi dhe gabimi. Prandaj, ky obligim, në parim, i kërkohet krejt umetit. Krahas mirësisë dhe lavdërimit, besimtari duhet të meditojë se si Allahu i Plotfuqishëm e ka përgjithësuar, duke thënë: **“Ju jeni populli më i mirë...”**, e nuk ka thënë: “Disa prej jush janë më të mirë...” Ndërkaq, kur vjen në shprehje të obliguarit dhe të ngarkuarit, i Lartësuarit ka bërë lehtësime, duke thënë: **“Le të dalë prej jush një grup...” (Ali Imran, 104)**, respektivisht disa prej jush, ngase detyra e përmirësimit është e vështirë, ndaj pakkush mund ta durojë.

Është gabim të mendohet se kjo çështje vlen për një grup të caktuar apo për organe përkatëse (të rendit). Assesi. Për më shumë, urdhri vlen për të gjithë, duke u argumentuar me fjalën e të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i cili thotë: *“Kushdo që sheh ndonjë të keqe, le ta ndryshojë me dorën e tij. E, nëse nuk mundet, atëherë me gjuhën e tij. E, nëse nuk mundet, atëherë (le ta urrejë) me zemrën e tij, ndonëse ky është besimi më i dobët.”*¹ Pra, secili sipas mundësisë së tij. Organet e caktuara nga kryetari i shtetit kanë pushtet dhe kompetencë aq sa u ka dhënë kryetari. Sa i përket masës së gjerë, prej secilit kërkohet përmirësimi, pengimi i gabimit dhe rregullimi i devijimit në bazë të dijes që kanë, bërë në mënyrë të

¹ Shënon Muslimi.

përshatshme, ndërtuar mbi urtësi e fjalë të bukura (ose këshilla efikase).

Madje, kjo përfshin edhe atë që gabon. Nga i tilli kërkohet që ta ndalë dhe ta llogarisë vetveten, si dhe ta ndalë tjetrin, qoftë edhe nga gabimi në të cilin ka rënë vetë, në mënyrë që të mos bashkojë dy të këqija: mëkatimin dhe indiferencën ndaj tij.

Urdhërimi për të mirë dhe largimi nga e keqja duhen shikuar përmes portës së tyre të gjerë. Kjo fe është madhështore, gjithëpërfshirëse për jetën e kësaj bote dhe jetën e përtejme. Njerëzimit i ka përshkruar metodologjinë e lumturisë dhe fitimit. E si të mos bëhemi thirrës të kësaj feje, që thërrasin përmes kësaj metodologjie gjithëpërfshirëse? Allahu i Lartësuar për këtë umet ka thënë: **“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun.”** (Ali Imran, 110)

Pra, ka përmendur të mirat dhe të këqijat, e nuk ka thënë “të lejuarën dhe të ndaluarën” sepse ajo që është përmendur në ajet është më e gjerë, më gjithëpërfshirëse. Përfshin çdo vepër të mirë e të keqe në etikë, moral, sjellje dhe adhurim. Sot problemi ynë qëndron në faktin se ne e kemi kufizuar këtë rit në kënde të ngushta, kemi gjykuar përmes këndeve në fjalë dhe më pas e kemi gjykuar shoqërinë me shkatërrim, humbje dhe pafuqinë e këtij riti. Kjo nuk është e saktë. Nëse umeti e kupton se kjo përgjegjësi kërkohet nga secili individ,

atëherë secili prej nesh bën atë që i takon, pavarësisht a është dijetar, i arsimuar, gazetar, edukator, tregtar apo diç tjetër.

Secili prej nesh duhet të thërrasë në udhëzim e të paralajmërojë nga devijimi, varësisht nga pozicioni dhe veprimtaria e tij. Kësisoj, i tërë umeti do të ketë mirësi dhe dobi. Ajo që më së shumti duhet të urdhërohet është Islami, kurse ajo që më së shumti duhet të ndalohet është politeizmi (shoqërimi Allahut dikë tjetër në adhurim) dhe *kufri* (mohimi). Mu këtu vërehet neglizhencë, ndërkohë ky është qëllimi kryesor i këtij riti fetar. Në librin *Mustedrek* transmetohet nga Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, lidhur me fjalën e Allahut të Lartësuar: **“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin”** se ka thënë: “Do t’i tërhiqni me zinxhirë e t’i futni në Islam.”¹

Ndër objektivat e këtij riti madhështor është edhe largimi i shkaqeve të dënimit, ulja e formave të degjenerimit, rritja e fushave të mirësisë. Njashtu, një prej objektivave është edhe bashkimi dhe kompaktësia, e jo ndarja dhe armiqësia, duke u argumentuar me fjalën ‘umet’, përdorur më se një herë. Ndërkohë, të gjitha foljet janë përdorur në shumës (urdhërojnë, urdhëroni). Domethënë, ky veprim vlen për tërë umetin. Madje, Allahu i Lartësuar para urdhërimit për të mirë e pengimit

¹ Hakimi thotë se zinxhiri i këtij hadithit është i saktë, por Buhariu dhe Muslimi nuk e kanë regjistruar hadithin në fjalë.

nga e keqja, ka përmendur mbajtjen fort, lidhjen dhe vëllazërinë, tek thotë: **“Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër.”** (Ali Imran, 103)

Tutje, pas kësaj, ka përmendur paralajmërimin nga përçarja dhe grindja. Allahu thotë: **“Mos u bëni si ata që, pasi u erdhën provat e qarta, u përçanë dhe u grindën. Për këta do të ketë dënim të madh”** (Ali Imran, 105) duke sinjalizuar rëndësinë e domosdoshmërisë së kujtimit të këtij objektivi, kujdesin për urdhërimin e çdo gjëje që kontribuon në fuqinë dhe bashkimin e umetit, si dhe ndalimin e çdo të keqeje që ndikon në unitetin dhe bashkimin e umetit.

Pavarësisht nga fakti se urdhërimi i njerëzve për të mirë dhe ndalimi i tyre nga e keqja mund të jetë e vështirë e mund të ketë edhe neveri, megjithatë Allahu i Lartësuar na ka tërhequr vërejtjen për domosdoshmërinë e bashkimit dhe afrimit. Madje, miqësimi i besimtarëve është shkak për kryerjen e këtij riti. Medito fjalën e Allahut të Lartësuar: **“Besimtarët dhe besimtare janë miq për njëri-tjetrin. Ata urdhërojnë që të bëhen vepra të mira dhe i ndalojnë të këqijat.”** (Et Teube, 71) E këtë nuk e përmend kur përshkruan hipokritët, të cilët vepruan të kundërtën e kësaj. Allahu i Lartësuar thotë: **“Hipokritët dhe hipokritet janë të ngjashëm me njëri-**

tjetrin: kërkojnë që të bëhen vepra të këqija e pengojnë të mirat.” (Et Teube, 67)

Bazuar në këtë, arrijmë të kuptojmë se sa e rëndësishme është butësia dhe t’ua duash të mirën të tjerëve, përpjekja për t’i shpëtuar ata e për të mos i vënë në rrezik. Sa shumë kanë kontribuar organet e ndryshme për bashkim dhe unitet, për pajtimin e ndarjeve dhe shpëtimin e shumë individëve e familjeve përmes këshillës dhe mbulimit.

Medoemos duhet të kuptohet kjo çështje: nëse pengimi nga e keqja çon drejt më të keqes, atëherë duhet lënë. Ibn Kajimi thotë: “Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ia obligoi umetit të tij ndalimin nga e keqja në mënyrë që përmes kësaj ndalese të arrihet mirësia, ajo që e do Allahu dhe i Dërguari i Tij. E, nëse ndalimi nga e keqja rezulton me një të keqe më të madhe apo më të urryer tek Allahu dhe i Dërguari i Tij, atëherë kjo ndalesë nuk arsyetohet, edhe po qe se Allahu i urren dhe nuk i do ata që e veprojnë atë, siç është ndalimi i pushtetarëve dhe dalja kundër udhëheqësve, sepse kjo konsiderohet baza e çdo të keqeje dhe sprovë deri në fund. Sahabët i kishin kërkuar leje të Dërguarit të Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, t’i luftonin pushtetarët që e vonojnë namazin (që e falin namazin jashtë kohës së vet), duke i thanë: “A t’i luftojmë ata?” Ai u qe përgjigjur: “Jo, për sa kohë që ata të falin namazin”, dhe ka thënë: “Ai që nuk pëlqen diçka

*nga udhëheqësi i tij, duhet të durojë dhe le të vazhdojë së binduri.*¹

Ai që mediton mbi atë çfarë i ka ndodhur Islamit në sprovat e mëdha dhe të vogla, do të hetojë se kjo i ka ndodhur për shkak të humbjes së këtij parimi madhështor dhe mosdurimit në përballje me të keqen. Donin ta largonin të keqen, por kjo ka rezultuar me një të keqe më e madhe. I Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selam*, në Mekë kishte parë të këqija më të mëdha, por nuk mundi t'i hiqte ato. Madje, edhe kur Allahu e çliroi Mekën, e u bë një vend islam, vendosi ta ndryshonte Qabenë e ta kthente në themelet që e kishte ngritur Ibrahim, mirëpo nuk e bëri këtë, edhe pse kishte mundësi, nga frika se mos ndodhte ndonjë e keqe më e madhe se ajo, gjë të cilën s'do të mund ta përballonin kurejshët, ngase ishin të sapoislamizuar dhe rishtas e kishin braktisur mosbesimin. Prandaj, nuk ua kishte lejuar që të keqen e pushtetarëve ta ndalonin me dorë, për shkak se kjo mund të rezultonte me një të keqe edhe më të madhe se paraprakja...

Pengimi i së keqes, vazhdon Ibn Kajimi, ndahet në katër shkallë:

E para: Mënjanimi i së keqes duke e zëvendësuar me një vepër të mirë;

¹ Shënon Muslimi.

E dyta: Pakësimi i saj duke mos e mënjanuar tërësisht;

E treta: Zëvendësimi i saj me ndonjë të ngjashme;

E katërta: Zëvendësimi i saj me ndonjë më të keqe se ajo.

Dy të parat janë të ligjshme, e treta është e diskutueshme, kurse e katërta është e ndaluar.

Nëse i sheh të shtururit dhe mëkatarët duke luajtur shah, pengimi i tyre nga ky veprim konsiderohet moskuptim, e jo mendjemprehtësi, përveç nëse ia arrin t'i largosh nga kjo drejt diçkaje që është më e dashur për Allahun dhe të Dërguarin e Tij, siç është hedhja e shigjetave, kalërimi, apo diç kësisoj. Ndërkaq, po qe se i sheh mëkatarët mbledhur rreth ndonjë loje, argëtimi apo dëgjimi, dhe i largon nga kjo drejt bindjes ndaj Allahut, atëherë ke realizuar qëllimin, në të kundërtën, lënia e tyre në këtë veprim është më e dobishme sesa angazhimi me diçka që konsiderohet më e keqe sesa këto, bie fjala, ndokush të merret me shkrimin e romaneve epshndjellëse a diç kësisoj, dhe ke frikë se, nëse e pengon, ai do të merret me librat e bidatit, devijimit dhe magjisë, atëherë lëre me librat e tij të parë. Kjo është një derë e gjerë. E kam dëgjuar shejhulislam Ibn Tejmijen duke thënë: “Në kohën e tatarëve, bashkë me disa shokë, kaluam pranë disa burrave që konsumonin alkool. Dikush, që ishte me mua, i pengoi nga kjo. Unë ia tërhoqa vërejtjen dhe e ndalova nga ky veprim duke i thënë: “Vërtet Allahu e ka ndaluar alkoolin, sepse largon nga

përmendja e Allahut dhe nga namazi, porse alkooli ata i largon nga mbytyja e robërimi i njerëzve dhe nga rrëmbimi i pasurisë, prandaj lëri ashtu siç janë.”

Nëse i kujtojmë këto domethënie dhe koncepte, arrijmë të kuptojmë si dhe kur duhet të pengojmë apo të urdhërojmë. Kjo asesi nuk nënkupton që të gjejmë pretekst për braktisjen e këtij riti fetar, por secili prej nesh duhet ta llogaritë vetveten. Prandaj, duhet kuptuar fakti se mëkati është gabim, mirëpo mosndalimi nga ai mund të konsiderohet gabim edhe më i madh. Allahu i Lartësuar thotë:

“Ata izraelitë që ishin mohues, u mallkuan me gjuhën e Davudit dhe të Isait, të birit të Merjemes, për shkak se kundërshtonin, shkelnin çdo kufi dhe nuk e ndalonin njëri-tjetrin të bënin vepra të këqija. Eh, sa të shëmtuara ishin veprat që bënin ata!” (El Maide, 78-79)

Allahu qorton gabimet e bëra dhe indiferencën karshi tyre. Gjithashtu Ai sqaron se përgjegjësia e ndalimit nga e keqja është obligim i tyre, madje edhe nëse ata vetë bien në mëkate.

POROSIA E SHTATË

DURIMI

“Dhe bëhu i durueshëm për çfarëdo që të godet! Me të vërtetë, ky është thelbi i patundur i të gjitha punëve!”

Nuk ka dyshim se sekreti i suksesit dhe arritjes, si dhe shkakut i fuqisë dhe guximit është durimi. Durimi konsiderohet gjysma e fesë. Gjysma e fesë është falënderimi, kurse gjysma tjetër durimi. Sa tipar madhështor është ky! Nuk gjen dot vlerë e të mos ketë durimin thelb të vetin. Durimi lë gjurmë në çdo veti tjetër. Bujaria kërkon durim për të shpenzuar pasurinë; trimëria kërkon durim për t’u përballur me armikun; drejtësia kërkon durim për ta thënë të vërtetën; falja e tjetrit kërkon durim kundrejt hakmarrjes; mëshira kërkon durim për sakrificë; ndershmëria kërkon durim kundrejt prostitucionit. Mu për këtë Lukmani porositi të birin me fjalët: **“Dhe bëhu i durueshëm për çfarëdo që të godet! Me të vërtetë, ky është thelbi i patundur i të gjitha punëve!”** Ai e dinte se durimi është mjet i suksesit dhe rrugë e shpëtimit në jetën e kësaj bote të përkohshme. Durimi është fjalë e shkurtër, mirëpo shumë domethënëse. Durimi është veti tejet delikate, mirëpo frytdhënëse e gjurmëlënëse. Durimi është pemë, që rrënjët i ka të forta dhe frutat e ëmbël. Një fjalë e urtë thotë: “Ëmbëlsia e suksesit shlyen hidhësinë e durimit.” Shiko fundin, e mos shiko mundimin dhe vuajtjet. Durimi

është i dobishëm i tëri, prandaj konsiderohet ndër mirësitë dhe dhuratat më të çmueshme.

Durimi është i njëjtë me emërtimin e vet: ka shije të hidhur, por fundi i tij është më i ëmbël se mjalti

Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, thotë: “Atë që përpiqet të durojë, Allahu do ta bëjë të durojë. Askujt nuk i është dhënë dhuratë më e mirë dhe më e përkryer sesa durimi.”¹

Hasan el Basriu ka thënë: “Durimi është një nga thesaret e mirësisë. Allahu ia dhuron atë vetëm robit të Tij fisnik. Durimi është cilësi e të dërguarve të zgjedhur e të vendosur, ashtu siç thotë Allahu i Lartësuar: **“Prandaj, ti bëhu i durueshëm (o Muhamed), ashtu siç kanë duruar me këmbëngulje të dërguarit e vendosur.” (El Ahkaf, 35)** Ju, që ju kanë kapluar brengat dhe ju kanë goditur shqetësimet, mos i humbni shpresat, sepse Allahu është larguesi i tyre. Sa e sa njerëz janë mbuluar në borxhe e shqetësime, por, ngaqë vazhdojnë të jenë të kapur pas fesë së të Fuqishmit e të Urtit, fundi është në favor të tyre!

Durimi është tipar që manifestohet në momente të vështira dhe të rënda. Në situata të tilla dallohen njerëzit dhe shfaqet burimi i mirësisë së tyre. Allahu i Lartësuar thotë: **“... e atyre që durojnë në kohë skamjeje, sëmundjeje dhe lufte.” (El Bekare, 177)**

¹ Shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

Durimi është mjet i besimtarit. Është dritë, përmes së cilës largon terrin e pashpresës dhe dëshpërimit. Sado që shtohen telashet dhe fatkeqësitë, durimi mbetet pishtar që ndriçon rrugën në errësirë, i jep shpresë të zotit dhe i shton shkëlqimin në të papriturat e kësaj bote. I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, thotë: “*Durimi është shkëlqim.*”¹

Jemi dëshmitarë të asaj se si të durueshmit i menaxhojnë sjelljet gjatë fatkeqësive, se si nuk iu errësohen të parët dhe vendimet për shkak të fatkeqësisë së madhe, por qëndrojnë stoikë. Kur fryjnë erërat e stuhishme të sprovave, nuk janë si trungjet e shkulura të palmave, por si palmat e larta që nuk ndalojnë së dhuruari, edhe nëse shtohen stuhitë dhe rriten rreziqet.

Nëse dëshiron model unik në këtë drejtim, le të meditojmë fuqinë e durimit në personalitetin e Profetit tonë, *sal-lallahu alejhi ue selem*, në tërë jetëshkrimin e tij.

Aishja, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, bashkëshortja e të Dërguarit, tregon se kishte pyetur Profetin: “A je ballafaqur me ndonjë ditë më të vështirë se ditën e (luftës së) Uhudit?” Ai iu përgjigj: “Kam hequr aq sa kam hequr nga populli yt, por dhimbja më e madhe ka qenë ditën e Akabesë, kur vajta tek Ibn Abdi Jalil Ibn Abdul Kulali, që nuk iu përgjigj kërkesës sime. Kështu, i mbuluar

¹ Shënon Muslimi.

me pikëllim të thellë, u largova duke vazhduar së ecuri pa pushuar, derisa e pashë veten në Karne Thealib. Aty ngrita kokën nga qielli dhe, papritur, pashë një re që më hijenonte, përmbi të cilën ndodhej Xhibrili, i cili më thirri dhe më tha: “Tashmë Allahu e ka dëgjuar fjalën që të tha ty populli yt dhe si t’u përgjigjën, andaj Allahu të ka dërguar engjëllin e maleve, kështu që mund ta urdhërosh të bëjë me ta çfarëdo që të duash.” Engjëlli i maleve më thirri, më përshëndeti dhe më tha: “O Muhamed! Më urdhëro ç’të duash! Po deshe, i bashkoj të dy malet (e luginës) dhe ua plas përsipër. Ndërkohë, Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, tha: “*Jo që jo. Madje, shpresoj se Allahu do të nxjerrë prej pasardhësve të tyre fëmijë që do të adhurojnë Allahun, Një e të Vetëm, pa i shoqëruar askënd në adhurim dhe pa adhuruar dikë tjetër pos Tij.*”¹ Shih durimin e Ebu Bekrit, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, ditën kur vdiq i Dërguari i Allahut. Ebu Bekri ishte trupdobët e thatanik, mirëpo burrëria nuk matet me madhështinë e fizikut, por me qëndrueshmëri në situata të vështira. Ai, para grumbullit të myslimanëve, me bindje të plotë tha: “Ai që e ka adhuruar Muhamedin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, le ta dijë se Muhamedi ka vdekur. Mirëpo, ai që e adhuron Allahun, le ta dijë se Allahu është i Gjallë, nuk vdes. Allahu i Lartësuar thotë: **“Muhamedi është vetëm i Dërguar, para të cilit ka pasur edhe të dërguar të tjerë. Nëse ai vdes ose vritet, a mos do të**

¹ Shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

ktheheni ju prapa? Kushdo që kthehet prapa, nuk i bën kurrfarë dëmi Allahut. Dhe Allahu do t'i shpërblejë falënderuesit.” (Ali Imran, 144) Është thënë: Beto hem në Allahun, sikur njerëzit nuk e dinin se Allahu e kishte shpallur këtë ajet, derisa e lexoi Ebu Bekri, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, me ç’rast njerëzit e morën prej tij dhe të gjithë të pranishmit e këndonin ajetin.”

Nëse të xhelozojnë për ndonjë vlerë me të cilën shquhesh, dije se (të tjerët do të) xhelozojnë çdo të shquar me vlerë.

Shih durimin e Jakubit, *alejhi selam*, në ndarjen e Jusufit që ishte djali më i dashur për të. Medito se si e përballoi lajmin e pikëlluar për humbjen dhe vdekjen e tij.

“Ai tha: “Nuk është kështu, por ju keni sajuar diçka (tjetër nga sa thoni). Por, durim i mirë! Allahut i kërkoj ndihmë kundër asaj që po tregoni ju.” (Jusuf, 18)

Vëreje praninë e kësaj vetie te Jakubi: në rastin e parë, kur e humbi loçkën e zemrës së tij, tha: **“Por, durim i mirë!”**

Pejgamberi thotë: *“Me të vërtetë, durimi duhet të jetë që në goditjen e parë.”*¹

Shiko pathyeshmërinë e Jakubit për këtë rast. Përfytyro gjendjen e tij tek e thoshte për herë të dytë, kur e kishte humbur djalin tjetër, vëllanë e Jusufit. **“Nuk është kështu, por ju keni kurdisur diçka. Unë do të kem durim. Shpresoj se Allahu do të m’i kthejë të gjitha, sepse Ai,**

¹ Shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

në të vërtetë, është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë.” (Jusuf, 83)

Gjithashtu thotë:

“(Jakubi) tha: “Unë dhimbjen dhe pikëllimin tim ia paraqes vetëm Allahut e nga Allahu di atë që nuk e dini ju.” (Jusuf, 86)

Dhe shiko fundin e këtij durimi se si Allahu i bashkoi ata, ia ktheu të parët, ia lartësoi pozitën dhe ia zbuloi të fshehtat e zemrave të djemve të tij. Kjo është zgjidhja dhe lehtësimi që vjen pas durimit.

Të paktë janë ata që përpiqen për ndonjë gjë, që kanë durim gjatë saj, e të mos fitojnë dhe të mos arrijnë suksese.

Shiko durimin e Jusufit, *alejhi selam*, i cili i gërshetoi të tri llojet e durimit: durimin në adhurim, kundrejt mëkatit dhe ndaj caktimeve të Allahut. Duroi për fenë e tij, duroi për parimet e tij. I thirri të burgosurit në fenë e Allahut, duroi në pus e në burg, si dhe përballoi të gjitha vështirësitë e vuajtjet. Duroi kundrejt mëkatit kur gruaja e Azizit e desh për vete, andaj Allahu ia lartësoi dhe ngriti pozitën, kurse sprovën ia kompensoi me mirësi më të dobishme.

Ja me ç’fjalë Lukmani e përshkroi durimin dhe punët e përmendura para tij:

“Me të vërtetë, ky është thelbi i patundur i të gjitha punëve!”

Të zotët e kësaj vetie nuk i spraps kurrfarë pengese, nuk i dobëson asnjë sëmundje e as nuk i ul a privon ndonjë

bllokadë, por, me mirësinë e Allahut, të gjitha këto i tejkalojnë, ngase i Lartësuari thotë: **“Bëhuni të durueshëm, se Allahu, me të vërtetë, është me të durueshmit.”** (El Enfal, 46)

E, me atë që është Allahu, pra, vullnetit të Tij, askush nuk mund t’i dalë përpara.

Një person kishte kaluar pranë një të paralizuari, që, njëherazi, ishte i verbër dhe i shurdhër, porse me gjuhën e tij nuk pushonte së lavdëruari Allahun e Lartësuar, andaj tha: “Falënderimi i takon Allahut, i Cili më ka mbrojtur nga kjo me të cilën të ka sprovuar ty dhe më ka begatuar kundrejt shumë krijesave.” Tjetri, i habitur nga kjo që dëgjoji, tha: “O vëllai im! Nga çka të paska mbrojtur Allahu?! Unë po shoh se ty të paskan goditur e mbledhur të gjitha belatë?” Ai ia ktheu: “Më lër e largohu nga unë, o ti i papunë! Allahu më ka mbrojtur duke më dhuruar gjuhën që e njëzon, zemrën që e njuh dhe e kujton Atë përherë.”

Pasi i ishte këputur këmba Urve ibn Zubejrit, e shikoi dhe tha: “O Allah, nëse më ke sprovuar, më ke mbrojtur; nëse më ke marrë diç, më ke lënë diçka tjetër; nëse më ke marrë një gjymtyrë, m’i ke lënë plot të tjera; nëse më ke marrë një djalë, më ke lënë djem të tjerë.”

Koha është dy ditë: njëra me rreziqe, tjetra e sigurt;

Jeta është dy llojesh: e çrregullt dhe e urtë.

Sipër detit qëndrojnë ngordhësit, kurse margaritarët në thellësi.

Në qiell eklipsohen vetëm Dielli dhe Hëna nga tërë kjo yjësi.

Të gjithëve do të na godasin shigjetat e kësaj jete, por duhet të durojmë duke e drejtuar ankesën tek i Plotfuqishmi. Ahnef bin Kajsi thotë: “Qeshë ankuar te xhaxhai im për një dhimbje barku, kurse ai më pat qortuar me fjalët: “Nëse të godet diçka, mos iu anko dikujt që është si ti, madje që është i paaftë ta largojë atë edhe nga vetvetja, por ankoju Atij që të ka sprovuar, sepse vetëm Ai është në gjendje të ta largojë atë. O djali i tim vëllai, me njërin sy nuk shoh tash e dyzet vjet, por, për këtë, nuk i kam treguar as gruas sime, as ndokujt tjetër të familjes.”

Nëse të godet ndonjë fatkeqësi, duro me ndihmën e Fisnikut, ngase Ai është më i mëshirshmi për ty.

Asnjëri nga ne nuk mund të kursehet nga sprovat e fatkeqësitë. Nëse sprovohet në veten e tij, në pasuri apo në fëmijë, një besimtari të bindur ndaj Zotit nuk i ka hije që, krahas dhimbjes, të privohet nga shpërblimi dhe sevapi, por duhet të durojë, të qëndrojë stoik, të pajtohet dhe të falënderojë.

Një gruaje, të vendit e kohës sonë, Allahu i kishte dhuruar një djalë, mirëpo djali i sëmuret në zemër. Kështu, zemra i kishte pushuar së rrahuri gjashtë herë, rrjedhimisht ishte në prag të vdekjes. Sa herë që e ëma njoftohej për gjendjen e tij, thjesht thoshte *elhamdulillah* (falënderimi i takon Allahut). Më pas kishte pësuar gjakderdhje në tru, saqë, pothuajse, truri i pushoi së funksionuari, kurse e ëma vazhdonte të thoshte *elhamdulillah*. Më pas u

diagnostikua me tumor të madh në kokë, ndërsa nëna vazhdonte të thoshte *elhamdulillah*. Pas një kohe i pushoi së funksionuari edhe veshka, kurse nëna edhe më tutje thoshte *elhamdulillah*. Pas pak, helmohet shumë rëndë, kurse nëna shqiptonte gjatë gjithë kohës *elhamdulillah*. Mbeti i paralizuar në krevat, as fliste, as dëgjonte, as lëvizte, por nëna e tij sërish thoshte *elhamdulillah*. Për plot gjashtë muaj të tërë vuajtje dhe dhimbje nëna ishte e durueshme, e kënaqur me caktimin e Allahut dhe falënderuese ndaj Tij. Lum për këtë grua! Habia më e madhe është kur kuptojmë se kjo foshnje ishte fëmija i parë i kësaj nëne, dhe atë, pas një pritjeje të gjatë prej plot shtatëmbëdhjetë vjetësh steriliteti.

A është imagjinatë a e vërtetë? Realitet. Kjo ka ndodhur në një prej spitaleve të vendit tonë. Pas një kohe, Allahu e shëroi këtë foshnje dhe e bëri të shëndoshë. Sa fuqi të madhe ke, o Allah! Sa e gjerë është mëshira Jote! Kush është me Allahun, Ai do të jetë me të. Kjo grua falte namaz nate, kishte sjellje të mirë, e respektonte burrin, andaj ja se si Allahu e nderoi dhe ia ngriti pozitën. I tillë është durimi. **“Allahu është me të durueshmit.” (El Bekare, 249)**

Ji i bindur ndaj Allahut, kthehu dhe kërkoji ndihmë Atij, e, nëse e bën, atëherë ti je i ndihmuari më i mirë.

Abdulumelik ibn Mervani thotë: “Durimi m’u bë aq i dashur, saqë u frikësova se po më humb shpërblimi.” Durimi ishte karakter dhe natyrë e tij. Fundi i tij ishte i lavdëruar. Arriti pushtet të madh dhe nder për t’i marrë

lakmi. Vallë, ku qëndron fshehtësia e këtij pushteti madhështor? Pa dyshim, në durim. Këto janë frytet e durimit dhe kjo është pozita e të durueshmëve. Ndër gjërat që e ndihmojnë njeriun të durojë, posaçërisht ndaj fatkeqësive, siç ka përmendur Ibn Kajimi, janë vijueset:

Një: Të kihet parasysh shpërblimi dhe sevapi;

Dy: Të kihet parasysh se fatkeqësitë i shlyejnë të këqijat;

Tre: Bindja se ato janë përcaktuar në Libër para krijimit tonë. Fatkeqësitë janë të pashmangshme, kurse mosdurimi ndaj tyre i shton edhe më tepër;

Katër: Njohja e së drejtës së Allahut gjatë fatkeqësisë, që është durimi dhe të kënaqurit me të. Besimtari është i urdhëruar të çojë në vend të drejtën dhe adhurimin ndaj Allahut gjatë fatkeqësisë, përndryshe atij do t'i shumëfishohet (sprovimi);

Pesë: Të kujtuarit se fatkeqësia mund t'i ndodhë për shkak të ndonjë mëkati të bërë, siç thotë Allahu i Lartësuar: **“Çfarëdo fatkeqësie që ju godet, është si pasojë e asaj që keni bërë vetë; por Ai fal shumë.” (Esh Shura, 30)**

Kjo vlen për të gjitha fatkeqësitë, të vogla e të mëdha. Kësisoj, zemra e tij do të përqendrohet drejt *istigfarit* (kërkimfaljes), që konsiderohet ndër shkaqet më të mëdha të mënjanimit të fatkeqësisë përkatëse. Ali ibn Ebu Talibi thotë: “Fatkeqësia vjen vetëm si pasojë e mëkatimit dhe largohet vetëm me pendim.”;

Gjashtë: Të kihet parasysh se Allahu është i kënaqur me atë që i ndodh atij dhe se Ai është që ia ka zgjedhur dhe

përcaktuar atë. Adhurim i plotë nënkupton të qenët i kënaqur me atë me të cilën është i kënaqur Zotëria i Tij. Nëse të drejtën e Allahut nuk e përmbush në këtë shkallë, atëherë kjo është për shkak të dobësisë së besimit të tij dhe gjendet në nivelin e durimit. E, nëse nuk e arrin as këtë shkallë, atëherë gjendet në nivelin e padrejtësisë; *Shtylla e fesë është të besosh në përcaktimin e Allahut, ndërkohë nuk ka mirësi në një shtëpi pa shtylla.*

Shtatë: Të kihet parasysh se kjo fatkeqësi është ilaç i dobishëm, të cilin ia ka çuar i Gjithëdijshmi në të mirë të robit të Tij, si mëshirë ndaj tij, i Urti në vendimet e Tij. Së këndejmi, le të durojë dhe të mos kundërshtojë me hidhërim e ankesë, me ç'rast dobia do t'i shkonte kot;

Tetë: Të kihet parasysh se në fund të këtij ilaçi ka shërim, gjallëri dhe shëndet. Largimi i dhimbjes nuk mund të realizohet pa të. Nëse shpirti e urren këtë ilaç dhe hidhësinë e tij, le t'i shikojë rezultatin dhe gjurmët e mira që lë;

Nëntë: Të kihet parasysh se fatkeqësia nuk ndodh për ta mbytur e shkatërruar atë, por bëhet për ta sprovuar durimin e tij dhe për t'u sqaruar a është i denjë për adhurimin e Zotit të tij dhe a mund ta bëjë të afërm dhe ndihmëtar të Tij apo jo? Nëse tregohet i qëndrueshëm, atëherë e zgjedh, e, nëse zbrapset, e largon;

Dhjetë: Të kihet parasysh se Allahu e edukon robin e tij në mirëqenie dhe në vështirësi, në mirësi dhe në fatkeqësi. Ai nxjerr nga robi adhurimin ndaj Tij në të gjitha situatat.

Kësisoj, me këtë arrijmë të kuptojmë se mjetin e durimit e zbulojnë qëndrimet dhe sprovat. Gjurmët e durimit manifestohen në goditjen e parë. Të folurit rreth moralit të durimit është e lehtë, mirëpo të edukuarit me këtë veti është më i rëndësishëm, ashtu siç ka vepruar Lukmani me të birin e tij.

POROSIA E TETË

MODESTIA

“Mos shtrembëro fytyrën tënde prej njerëzve dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se Allahu nuk i do mendjemëdhenjtë e mburracakët!”

Mendjemadhësia është një veti e qortuar. Mjafton fakti se ajo është veti e djallit të mallkuar, Iblisit, dhe ndër shkaqet më të mëdha të devijimit. Mendjemadhësia konsiderohet mëkati i parë me të cilin i është bërë mëkat Allahut. Ai thotë: **“Kur u thamë engjëjve: “Përluni në sexhde para Ademit”, ata u përlën, përveç Iblisit, i cili nuk deshi, u tregua mendjemadh dhe u bë jobesimtar.”** (El Bekare, 34)

Lukmani, në këshillën drejtuar të birit, udhëzoi drejt modestisë me njerëzit. Ai i tha: **“Mos shtrembëro fytyrën tënde prej njerëzve dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se Allahu nuk i do mendjemëdhenjtë e mburracakët!”**

Nëse kjo bimë e keqe rritet dhe kultivohet te njeriu, do ta çojë drejt shkatërrimit. Nëse meditojmë këtë porosi, do të vërejmë se ajo ndalon dy portrete të mendjemëdhenjve, e nuk ka ndonjë të tretë: ose kanë për ta shfaqur mendjemadhësinë kundrejt njerëzve, ose do të jenë të vetmuar.

Ndalesa e parë ka ardhur për ta sqaruar portretin e parë: **“Mos shtrembëro fytyrën tënde prej njerëzve.”** Sa veti e keqe që është kjo: dikush të shohë veten më të mirë se tjetri, aq sa të shtrembërojë qafën kur u flet njerëzve ose i shikon me mendjemadhësi e kryelartësi! Njeriu më i urryer te njerëzit është ai që veten e mendon se është në pozitën që nuk mund të arrijë askush tjetër. I tilli vazhdimisht përbuz të tjerët e i shikon nga lart. I tilli është mjeran. Përse ta mbajë hundën përpjetë, kur fillimi i tij është një pikë fare, thërrmijë, fundi kufomë e ndyrë, kurse mes këtyre dyjave bart jashtëqitje?! Për Zotin, i tilli nuk e di se me këtë sjellje të tjerëve u jep arsye që të nënçmohet e të ofendohet. Dashuria e vërtetë nuk matet me rrahjen e shuplakave, por me rrahjen e zemrave.

Fjala **shtrembërim** dëshmon dhe sqaron qartë shëmtinë e portretit të mendjemadhit të vetëkënaqur. Ndërkaq, togfjalëshi **fytyrën tënde** portretizon gjendjen e personit të mashtruar e të vetëkënaqur. Allahu na shfaq shëmtinë e mendjemadhësisë në këtë pamje, që merr formë tjetër ky mendjemadh. Allahu e ka përsosur krijimin e tij, mirëpo, ngaqë u keqësua sjellja e tij, iu ndryshua edhe krijimi me këtë pamje të shëmtuar me të cilën është i kënaqur mendjemadhi. Mendjemadhi ka qafë të përdredhur dhe fytyrë asimetrike.

Ndërkaq, portreti i dytë shfaqet në mënyrën e ecjes së tij në tokë, prej së cilës është krijuar, si dhe rikujtimin se vendi i ecjes është toka, te fjala e të Lartësuarit: **“... dhe**

mos ec në tokë...”, ndonëse të ecurit bëhet në tokë. Kjo sinjalizon se të ecurit e tij bëhet në një vend ku ecin të gjithë njerëzit e tjerë, të fuqishmit dhe të dobëtit, prandaj i tilli nuk ka ndonjë vlerë të veçantë. Gjithashtu, në këtë ka këshillë për atë që ecën me mendjemadhësi se, ai është i barabartë me të gjithë njerëzit e tjerë. Së këndejmi, përse kjo mendjemadhësi?!

Nëse mendjemadhi ka ndërtuar kodra urrejtjeje në zemrat e njerëzve, le ta dijë se Zoti i njerëzve nuk e do atë dhe ky fakt i mjafton për shkatërrimin dhe nënçmimin e tij. Allahu i Lartësuar thotë: **“Mos shtrembëro fytyrën tënde prej njerëzve dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se Allahu nuk i do mendjemëdhenjtë e mburracakët!”**

Mendjemadhi mashtrohet me vetëpëlqimin duke menduar se është i nderuar dhe i respektuar. I gjori, nuk e di se ai është i urryer, e jo i dashur. Krenohet, ngase është i sëmurë me dashuri të rreme të vetvetes. Tregohet mendjemadh sepse i injoron të vërtetat dhe jeton në iluzione. Ngrëh kurorën, e nuk e di se një ditë ajo do të futet në tokën mbi të cilën ecën. Trupi dhe kockat e tij, me të cilat krenohet, do të shndërrohen në mbeturinë, të cilat, me gjasë, edhe do të shkelen me këmbë.

Kjo porosi bën thirrje për modesti gjatë të folurit dhe të ndërvepruarit. Modestia është cilësi e besimtarëve të sinqertë, e robërve të të Gjithëmëshirshmit. **“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër**

Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: “Paqe qoftë!” (El Furkan, 63)

Sado që do të të lartësohej grada apo të të shtohej pasuria, në fund, thjesht, je njeri, si çdo njeri tjetër. Ki kujdes dhe njerëzit trajtoji si njerëz, në mënyrë që Allahu të të ngrejë dhe të ta lartësojë pozitën. Vazhdimisht ki në mendje se ne të gjithë jemi robër të Allahut, të gjithë jemi shpirtra futur në trupa. Rishiko veten përpara se të të joshë krenaria dhe kryelartësia. Kujto se njeriu më madhështor në këtë dhe në jetën e përtejme është Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ndërkohë ai ka jetuar modest, ka vdekur modest, si dhe ka urdhëruar e inkurajuar për modestinë, duke thënë: “*Sadakaja nuk e pakëson pasurinë. Njeriut që fal, Allahu ia shton krenarinë, kurse atë që tregohet modest, Allahu e ngrit.*”¹

Mu për këtë, Allahu është i kënaqur vetëm me modestinë, duke e mbrojtur nga vesi i mendjemadhësisë. Edhe pse Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ishte lavdëruar nga Zoti i botëve në ajetin, që quhet *ajeti i virtyteve*: “**Se ti je me virtyte madhore.**” (El Kalem, 4), Allahu i Lartësuar, për shkak të sjelljes së tij me të dobëtit dhe të gjorët, e ka qortuar në Kuran jo vetëm në një vend. Allahu i Lartësuar thotë: “**Ai u vrenjt dhe ktheu kurrizin, kur i erdhi pranë i verbri.**” (Abese, 1-2)

¹ Shënon Muslimi.

Po ashtu, Allahu i Lartësuar thotë: **“Dhe qëndro me ata që i luten Zotit të vet në mëngjes dhe mbrëmje, duke dëshiruar Fytyrën (kënaqësinë) e Tij dhe mos i shmang sytë nga ata (te të tjerët), duke dëshiruar stolitë e shkëlqimin e kësaj jete. Mos dëgjo atë, zemrën e të cilit ia kemi lënë mospërfillëse ndaj përmendjes Sonë e, që shkon pas dëshirave të veta, duke shkelur çdo kufi në veprimet e veta.”** (El Kehf, 28)

I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, nuk i përbuzi e as nuk u tregua mendjemadh ndaj tyre, mirëpo shpresonte ta pranonin Islamin ata që gëzonin pozitë të lartë shoqërore, të cilët krenoheshin ndaj të gjorëve dhe kërkonin nga Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, t’i largonte nga ndejat e tij. Sadi transmeton duke rrëfyer: “Ishim gjashtë veta bashkë me Pejgamberin, kurse idhujtarët i thanë të Dërguarit: “Dëboji këta, që të mos na pengojnë.” Sadi thotë: “Prej këtyre të gjashtëve ishim unë, Ibn Mesudi, një njeri nga fisi Hudhejl, Bilali dhe dy të tjerë, emrat e të cilëve nuk më kujtohen, kur të Dërguarit i zbriti ajeti: **“Mos i dëbo ata që i luten Zotit të vet në mëngjes e mbrëmje, duke e dëshiruar Fytyrën (mirësinë) e Tij!”** (El Enam, 52)

Allahu i Lartësuar, përmes këtyre ngjarjeve, na mëson si ta largojmë nga vetvetja çdo lloj mendjemadhësie që mund t’i ekspozohet zemrës. Mendjemadhësia tërësisht është e dëmshme dhe e keqe, dëmi i saj është i dukshëm. Ndër të këqijat e saj është se njerëzit të urrejnë. A ke

vënë re se mendjemadhësia konsiderohet mjeti më i shpejtë për mbjelljen e urrejtjes në zemra, kurse modestia vetia më me vlerë për tërheqjen e dashurisë së njerëzve ndaj teje. Andaj, ja zgjidh që të jesh i urryer në të gjitha zemrat, ja të jesh i dashur për të gjitha zemrat. Po qe se mendjemëdhenjtë do ta kujtonin llahtarinë e Ditës së Kiametit, errësirën e varrit dhe krimbat që do t'i hanë trupat e tyre, pa dyshim, modestinë do ta bënin slogan të tyrin, kurse për butësinë do të kujdeseshin e do të ishin të vëmendshëm.

Mendjemadhësia, krahas asaj që u tha, konsiderohet ndër shkaqet më të mëdha të mohimit të së vërtetës. Allahu i Lartësuar përkitazi me Iblisin thotë: **“Allahu tha: “Çfarë të pengoi ty të mos përuleshe, kur të urdhërova?” Ai iu përgjigj: “Unë jam më i mirë se ai. Mua më krijove nga zjarri, kurse atë e krijove nga balta.” Allahu i tha: “Atëherë, zbrit prej andej (Xhenetit)! Ti nuk ke të drejtë që të krenohesh në të! Shporru, me të vërtetë, ti je prej të poshtëruarve.” (El Araf, 12-13)**

Dhe thotë: **“Kështu, ata i mohuan ato padrejtësisht dhe me mendjemadhësi, edhe pse shpirti i tyre i besonte për të vërtetë.” (En Neml, 14)** Po ashtu, kujto fjalën e Allahut të Lartësuar: **“Do t'i largoj prej shenjave të Mia ata që sillen me arrogancë në Tokë.” (El Araf, 146)**

Ndërkaq, në të kundërt të saj: **“Sa për shtëpinë e botës tjetër, Ne do ta caktojmë atë për ata që nuk kërkojnë as madhështi e as ngatërresa në Tokë. Përfundimi (i mirë) është për ata që ruhen nga të këqijat.” (El Kasas, 83)**

Dije se mendjemadhi, në mënyrë që ta ruajë krenarinë dhe kryelartësinë, është “i detyruar” që ta veprojë çdo ves; si dhe, për ta mbrojtur mendjemadhësinë e tij, duhet të heqë dorë prej çdo tipari të lavdëruar. Mendjemadhësia nuk e lë të stoliset me asnjë moral të banorëve të Xhenetit. Nuk është për t’u habitur, ngase Pejgamberi ynë, *sal-lallahu alejhi ue selem*, na njofton se: *“Nuk do të hyjë në Xhenet ai që në zemrën e tij ka një grimcë mendjemadhësie.”*¹

Dhe nuk ka ves të xhehenemlinjve që ky të mos e ketë. Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, thotë: *“A t’ju tregoj për banorët e Xhenetit? Çdo i dobët (nga modestia), që njerëzit e konsiderojnë të pafuqishëm, që, po të betohej në Allahun (për diçka), Allahu do t’ia përmbushte betimin e tij. Po për banorët e Zjarrit, a t’ju tregoj? Ai që, kur armiqësohet (grindet), kalon çdo kufi, që ka pak durim dhe që është mendjemadh.”*²

Të largohemi nga vetëmashtrimi, nga prirjet e Iblisit, në mënyrë që djalli të mos na joshë drejt mëkatit me të cilin e kundërshtoi Allahun. Ki parasysh se Allahu i Madhërishëm nuk pajtohet që dikush tjetër të krahasohet me Të në aspektin e madhështisë. I Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, (në një hadith kudsii), ka thënë: *“Krenaria është mbështjellësja Ime (rida-pjesa e sipërme e ihramit), kurse madhështia është petku*

¹ Shënon Muslimi.

² Shënon Buhariu.

*Im (izar-pjesa e poshtme e ihramit). Kështu, atë që dëshiron të krahasohet me Mua në këto dy gjëra, do ta dënoj!*¹

Mendjemadhësia është cilësi e njerëzve të mangët, kurse modestia virtyt i fisnikëve. Rrëfëhet se një ditë një mysafir kishte vajtur te kalifi Omer ibn Abdulaziz. Gjatë qëndrimit të tyre u fik llamba. Kalifi Omer u çua dhe e ndreqi. Mysafiri iu drejtua me fjalët: “O prijës i besimtarëve! Përse nuk më urdhërove mua, apo ta thirrje shërbëtorin që të merrej me të?” Kalifi Omer iu përgjigj: “U çova duke qenë Omeri, e mbeta edhe më tutje Omeri (nuk më gjeti asgjë).”

Meqë mendjemëdhentë janë njerëzit më të nënçmuar në zemrat e njerëzve në jetën e kësaj bote, ndonëse kanë pozita dhe paga të larta, në Ditën e Kiametit do të jenë njerëzit më të nënçmuar në pozita dhe momente më madhështore, ngase shpërblimi bëhet paralel llojit të veprës. Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, thotë: *“Mendjemëdhentë Ditën e Kiametit do të ringjallen në madhësinë e një grimce në formë njeriu. Ata do të nënçmohen nga çdo anë, e pastaj do të dërgohen në një burg të Xhehenemit të quajtur “Bules”. Sipër tyre gjendet zjarri i Xhehenemit dhe do t’u jepet për të pirë nga lëngu i shtrydhur i banorëve të Xhehenemit.”*²

¹ Shënon Muslimi.

² Shënojnë Nesaiu dhe Tirmidhiu (motërzimi i të cilit është dhënë), i cili thotë se ky hadith është hasen.

Në jetën e kësaj bote mund të ndëshkohen jo sipas qëllimit të tyre. Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, thotë: “*Ndërsa një njeri me petka të bukura, me pëlqim në vetvete dhe me flokë të krehur ecte me mendjemadhësi, mu në atë çast Allahu i Madhëruar e fundosi në dhé, e vazhdon të fundoset deri në Ditën e Gjykimit!*”¹

Mendjemëdhenjtë do të privohen nga afërsia e Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*. Ai thotë: “*Njerëzit që i dua më së shumti në mesin tuaj dhe që do të jenë më afër meje Ditën e Gjykimit janë të moralshmit. Ndërkaq, më të urryerit tek unë dhe më larg meje Ditën e Gjykimit janë llafazanët, kryeneçët dhe mutefejhikunët.*” Të pranishmit i thanë: “O i Dërguari i Allahut, dimë ç’janë *llafazanët* e *kryeneçët*, porse këta të fundit, *mutefejhikunët*, nuk e dimë.” Ai iu përgjigj: “*Mendjemëdhenjtë.*”²

Mendjemadhësia nuk nënkupton rrobat e bukura, por fshihet në zemër dhe reflekton në sjelljen me njerëzit. Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, thotë: “*Nuk do të hyjë në Xhenet ai që ka një grimcë të imët mendjemadhësie.*” Një njeri i tha: “Po ja që njeriut i pëlqen të ketë roba e këpucë të mira?” Pejgamberi iu

¹ Shënojnë Buhariu dhe Muslimi

² Shënon Tirmidhiu dhe ka thënë: Hadithi është hasen.

përgjigj: *“Allahu është i bukur dhe e do të bukurën. Mendjemadhësi është refuzimi i së vërtetës dhe sjellja ndaj njerëzve me arrogancë.”¹*

E tillë është mendjemadhësia, kryelartësi e rrejshme, ka fund të keq e të hidhur. Ndërkaq, modestia është lartësim e gradim, si dhe afërsi me krijesat dhe Krijuesin.

¹ Shënon Muslimi.

POROSIA E NËNTË

TË ECURIT ME KUJDES DHE TË FOLURIT ME ZË TË ULËT

“Ec me kujdes e i përmbajtur dhe fol me zë të ulët; se zëri më i vrazhdë është zëri i gomarit!”

Mesatarja dhe vetëpërmbajtja vazhdojnë të mbesin çështje të lavdëruara në çdo fe e komunitet, në çdo mendje e moral. Pikërisht me këtë e ka përmyllur porosinë e tij ndaj djalit, duke i thënë: **“Ec me kujdes e i përmbajtur dhe fol me zë të ulët; se zëri më i vrazhdë është zëri i gomarit!”**

Kjo porosi përfshin dy kode madhështore të etikës: kujdesin e përmbajtjen gjatë ecjes, si dhe uljen e zërit dhe, që të dyja, janë tipare të lavdëruara e morale të kërkuara.

Kujdesi i Lukmanit ndaj këtyre moraleve dhe elementeve të mirësjelljes tregon se edukata doemos duhet qenë complete, e jo e mangët. Nëse Lukmani porosinë e tij përmbledhëse e ka nisur me njëzim (*teuhid*) dhe ndalim nga idhujtaria (*shirku*), duke përmyllur me edukatën e ecjes dhe uljes së zërit, tërë kjo nënkupton se sa i domosdoshëm është gjatë edukimit kujdesi ndaj gjërave të përgjithshme dhe detajeve.

Le të meditojmë thënien e tij drejtuar të birit: **“Ec me kujdes e i përmbajtur”**, pas qortimit ndaj mendjemadhësisë, te fjala: **“Mos shtrembëro fytyrën**

tënde prej njerëzve dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se Allahu nuk i do mendjemëdhentë e mburracakët!” Lukmani nuk do që djali i tij të jetë mendjemadh, të mos ecë me kryelartësi, por as nuk e do të dobët e të brishtë, por i dëshiron të dobishmen, mesataren.

Me këtë udhëzim kompletohet edukata te ky djalë. Pasi i ati ia sqaroi edukatën e mirësjelljes me njerëzit, me vetveten, i udhëzoi mënyrën e të ecurit dhe të folurit. Sa i përket kodit të të ecurit, e udhëzoi të jetë mesatar e i matur, pasi e ndaloi nga mendjemadhësia. I tillë është mesi, as teprim, as cungim. Ibn Mesudi, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, përcjell: “Na ndalohej ecja shtruar e hebrejve dhe zvarritja e të krishterëve.”

Mesatarja në vepra është njëlloj si drejtësia në peshore. Maturia dhe mesatarja përherë kërkohen në çdo vepër e fjalë, virtyt e sjellje.

Lexues i nderuar, në udhëzimin e fëmijëve të tu përqendrohu në këto virtyte. Kujtojua mënyrën e të ecurit të Pejgamberit tonë të nderuar, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i cili ecte me modesti, por, njëherazi, me vetëbesim. Ka qenë njeriu më modest dhe më i afërt me njerëzit, por, njëherazi, më krenari gjatë të ecurit. Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, përcjell: “Nuk kam parë dikë të ketë ecur më shpejt se i Dërguari i Allahu, *sal-lallahu alejhi ue selem*, (dukej) sikur toka i hapej

përpara. Ne nguteshim e lodheshim që ta zinim, kurse ai as që ndiente lodhje.”

Ibn Kajimi thotë: “E tillë ka qenë ecja e profetëve të vendosur, ambiciozë dhe guximtarë: ecja më e drejtë, më e rehatshme për gjymtyrët dhe fare larg (përngjasimit të) ecjes së të marrit... Thuhet se Omer ibn Hatabi, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, kishte parë dikë duke ecur kokulur, si vdekatar. Omeri e goditi me shkop dhe i tha: “Mos na e vdis Islamin.”

Kështu, arrijmë të kuptojmë se, ndonëse krenaria e rreme dhe mendjemadhësia qenkan të qortuara në Islam, hiç më pak të qortuara nuk janë dobësia dhe poshtërimi. I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, thotë: “*Besimtari i fortë është më i mirë dhe më i dashur tek Allahu sesa besimtari i dobët.*”¹

Prandaj, myslimanët, në përgjithësi, dhe të rinjtë, në veçanti, duhet të kuptojnë se, të ecurit dhe forma e saj është një ndër treguesit e personalitetit të njeriut. Nëse krenaria pa kryelartësi e dyfaqësi gjatë ecjes lypset te burrat, tek ecja e grave është e lavdëruar të mbizotërojë ndrojtja. Allahu i Lartësuar, lidhur me njërën prej bijve të njeriut të mirë, thotë: “**Më vonë, njëra nga ato dyja, erdhi me ndrojtje dhe i tha: “Babai im të fton për të të shpërblyer, se i dhe ujë (tufës sonë).”** (El Kasas, 25)

¹ Shënojnë Muslimi, Ahmedi dhe të tjerët.

Është e papranueshme që burri të ecë si femrat, e femrat të ecin si burrat.

Lukmani i ka thënë të birit: “Të jesh i matur në ecjen tënde”, e nuk i ka thënë: “Drejtoje ecjen tënde”, ngase ka për qëllim përmirësimin e mënyrës së ecjes, e jo vetë ecjen. Pra, synohet forma dhe cilësia, ngase thjesht ecja as qortohet, as lavdërohet. Të ecurit ia ka atribuar vetë atij, duke i thënë **ecjen tënde**, që t’i tërhiqte vëmendjen se sa i domosdoshëm është kujdesi ndaj asaj që i takon atij, sepse kjo edukatë ka të bëjë me çështjen e vetë personit.

Pasi u përqendrua rreth kodit të ecjes, porosinë e plotësoi me etikën e të folurit: “... **dhe fol me zë të ulët.**” Pra, gërshetoi të ecurit dhe zërin, ngase ka lidhshmëri të madhe ndërmjet gjuhës së trupit dhe gjuhës së të folurit. Këtë e vërejmë më me hollësi ndërmjet të ecurit dhe arsyes, sikur që pamë te përshkrimi i vajzës që kishte vajtur te Musai, *alejhi selam*. Njashtu, këtë e vërejmë edhe në përshkrimin e robërve të të Gjithëmëshirshmit, ku Allahu i Lartësuar thotë: **“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: “Paqe qoftë!” (El Furkan, 63)**

Prandaj, njeriu nuk duhet t’i lëshojë vetes frerët, e të mos dijë sa po flet. Ai, ose ka zë të ulët, sa të mos i kuptohet të folurit e të mos i dëgjohet pëshpëritja, ose ka zë të neveritshëm, aq sa, kur flet, detyrohet të mbyllësh

veshët, ngase mbush hapësirën me bërtitje. Kurrsesi. As të parën, as të dytën. Kërkohet mesatarja: “... dhe fol me zë të ulët.”

E urdhëroi me uljen e zërit, sepse, krahasuar me të, e keqja, qortimi dhe shqetësimi më i madh është në ngritjen e zërit sesa në uljen e tij. Allahu i Lartësuar ka edukuar sjelljen e shokëve të Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, përmes udhëzimit hyjnor, që ndërlihet me edukatën e të folurit dhe ngritjes së zërit. Allahu thotë:

“O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Profetit dhe mos i flisni atij me zë të lartë, siç bëni me njëri-tjetrin, në mënyrë që të mos ju humbin veprat tuaja pa e ndier ju fare. Vërtet, ata që ulin zërin në prani të të Dërguarit të Allahut janë njerëzit, zemrat e të cilëve Allahu i ka kalitur për besim e përkushtim. Për ata ka falje dhe shpërblim të madh. Vërtet, ata që të thërrasin ty (o Muhamed) me zë të lartë nga jashtë dhomave të tua, shumica e tyre nuk marrin vesh. E sikur të duronin derisa ti të dilje jashtë tek ata, do të ishte më mirë për ata. Por Allahu është Falës dhe Mëshirues.” (El Huxhurat, 2-5)

Po qe se njeriu do të meditonte gjendjen e tij në mesin e krijesave, do të vërente se në botën njerëzore zëri i ulët dhe i qetë është i pranueshëm, kurse të folurit me zë të lartë dhe të bërtiturat janë të papranueshme. Ndërkaq, në botën shtazore bie në sy ngritja dhe vrazhdësia e zërit. Mu për këtë, për t’u distancuar nga kjo çështje, i është

drejtuar me fjalët: “... fol me zë të ulët; se zëri më i vrazhdë është zëri i gomarit!” Ashpërsia e zërit të gomarit është e njohur si diç e panevojshme. Fillon me frymënxjerrje e vijon me frymëmarrje, gjë që janë veprime të banorëve të Xhehenemit. Gomari është sinonim i gërshetimit të të gjitha të këqijave.

Besimtari duhet të kuptojë se Islami i kushton kujdes këtyre sjelljeve dhe nuk duhet të bëjë si disa që nuk përfillin fare kodin e ecjes dhe të të folurit. Sheh se si ngre zërin lart pa ndonjë nevojë, apo qesh me zë të lartë. Njerëzit e shikojnë me habi, kurse ai as që e vëren, andaj as që i kushton kujdes kësaj. Të tillët e kanë humbur këtë ndjenjë delikate. Në këtë mënyrë sillen në treg dhe vende publike, pa kujdes, pa shije dhe pa edukatë. Në *Sahihun e Buhariut* është shënuar përshkrimi i Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*: “Nuk është i pasjellshëm e i ashpër, nuk bërtet në treg dhe të keqen nuk e kthen me të keqe, por fal dhe mëshiron.”

Doemos, duhet të kuptojmë se këto gjëra janë të fesë sonë, andaj duhet t’u kushtojmë kujdes dhe të identifikohemi me to. Ne pasojmë fenë madhështore e gjithëpërfshirëse, me edukim në të gjitha fushat e jetës, prandaj identifikohu me fenë, parimet dhe edukatën e saj.

Sadi, në *Tefsirin* e tij, thotë: “Porositë me të cilat Lukmani e ka porositur të birin ngërthejnë bazat e urtësisë dhe detyrojnë edhe ato që nuk janë përmendur. Krahas çdo porosie, shoqërohet edhe nxitja për ta zbatuar, në rastet

kur është urdhër, apo për ta lënë, në rastet kur ka ndalesë. Kjo komenton atë që është përmendur në përshkrimin e urtësisë prej fillimit, që është dija mbi dispozitat dhe dobitë. Po të shikojmë me vëmendje, do të hetojmë se Lukmani e kishte urdhëruar djalin e tij me bazën e fesë, *njëzimin*, dhe e kishte ndaluar nga *politeizmi*, i kishte sqaruar atë nga e cila doemos duhej të largohej. E kishte urdhëruar me respektimin e prindërve dhe i kishte shpjeguar shkakun detyrues të respektimit të tyre, e kishte urdhëruar ta falënderonte Allahun dhe prindërit e tij, e, më pas, i kishte tërhequr vërejtjen se respektimi dhe bindja ndaj tyre duhet të jetë për sa kohë që ata nuk urdhërojnë në mëkatim. Megjithatë, ai nuk duhet të tregohet i pabindur ndaj tyre, por të sillet mirë me ta, edhe nëse nuk u bindet atyre kur e urdhërojnë për politeizëm. E kishte urdhëruar të kishte parasysh frikën ndaj Allahut dhe i kishte kujtuar kthimin tek Ai, si dhe që nuk mund t'i përvidhej asgjë e vogël apo e madhe, e mirë apo e keqe, porse atë do ta nxjerrë në shesh.

E kishte ndaluar nga mendjemadhësia dhe i kishte urdhëruar modestinë. E kishte ndaluar nga mohimi i së vërtetës dhe nga sjellja me arrogancë ndaj njerëzve. E kishte urdhëruar me qetësi në lëvizje dhe uljen e zërit, si dhe e kishte ndaluar nga ngritja e zërit. E kishte urdhëruar që të urdhëronte për të mirë dhe të ndalonte nga e keqja, të falte namazin dhe të duronte, gjëra këto përmes të cilave lehtësohet çdo çështje, siç thotë Allahu i Lartësuar. Ai që porositi me këto këshilla, është i denjë

të cilësohet dhe të veçohet me urtësi. Prandaj, nga mirësia e Allahut ndaj Lukmanit dhe ndaj të gjithë robërve të Tij ua rrëfeu atyre urtësinë e tij, që të jetë model dhe shëmbëlltyrë.

Në fund, kjo qe e tëra që m'u mundësua të përmbledh nga këto porosi madhore. E lus Allahun t'i sjellë dobi, si autorit, ashtu edhe lexuesit. Ai është i Plotfuqishëm për këtë.

Literatura

1. *Ahkam ehlu dhimeh*, Ibn Kajim el Xheuzije, me verifikim të Jusuf Ahmed El Bekriut dhe Shakir Teufik el Arurit, Daru Ibn Hazm, Damam, Bejrut, bot. I, 1418 h – 1997.
2. *I'lamul muvekine an rabil alemine*, Ibn Kajim el Xheuzije, me verifikim të Taha Abdurreuf Sadit, Darul Xhejl, Bejrut, 1393 h – 1973.
3. *Et Tahriru ue tenuiru*, Ibn Ashuri, Daru Sehnun, Tunis, 1418 h - 1997.
4. *Tefsirul Kuranil adhim*, Ibn Kethiri, me verifikim të Sami ibn Muhamed Selamehut, Daru Tajbeh, bot. II, 1420 h-1999.
5. *Tejsirul kerimi Rrahmani fi tefsiri Kelamil menani*, Es Sadi, me verifikim të Abdurahman ibn Muala el Luvejhikut, Muesesetu Risaleh, bot. I, 1420 h-2000.
6. *Reudatul muhibine ue nuz'hatul mushtakine*, Ibn Kajim el Xheuzije, Darul Kutubil ilmijeti, Bejrut, 1412 h- 1992.
7. *Zadul meadi fi hedji hajril ibadi*, Ibn Kajim el Xheuzije, me verifikim të Shuajb Arnautit dhe Abdulkadër Arnautit, Muesesetu Risaleh, bot. XIV, 1407 h - 1986.

8. *Sunenu Ebi Davud*, me verifikim të Muhamed Muhjedin Abdulhamidit, Darul Fikr.
9. *Fet'hul Bari sherhu Sahihil Buhari*, Ibn Haxheri, Daru Selam, bot. I, 1421 h - 2001.
10. *Fejdul Kadir sherhul Xhamiu Sagir*, El Menavi, El Mektebetut tixharijel kubra, Egjipt, Bot. I, 1356.
11. *Mexhmuul fetava*, Ibn Tejmije, me verifikim të Enver el Bazit dhe Amir el Xhezarit, Darul Uefa, bot. III, 1426 h – 2005.

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	3
PARATHËNIE.....	5
POROSIA E PARË.....	9
MOSSHOQËRIMI ALLAHUT ASGJË (NË ADHURIM).....	9
POROSIA E DYTË.....	15
RESPEKTIMI I PRINDËRVE.....	15
POROSIA E TRETË	25
NUK KA BINDJE (NDAJ TJETRIT) NË MËKATIM	25
POROSIA E KATËRT.....	33
MBIKËQYRJA E ALLAHUT.....	33
POROSIA E PESTË	41
NAMAZI	41
POROSIA E GJASHTË.....	50
URDHËRIMI PËR TË MIRË DHE NDALIMI NGA E KEQJA.....	50
POROSIA E SHTATË.....	60
DURIMI.....	60
POROSIA E TETË	72
MODESTIA.....	72
POROSIA E NËNTË	82
TË ECURIT ME KUJDES DHE TË FOLURIT ME ZË TË ULËT.....	82
Literatura	90